



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 27/45
Datë: 24.11.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 nëntor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Mbrojtjen e Konsumatorit.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

**Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade**

KONCEPT DOKUMENTI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

<u>Përmbledhje e koncept dokumentit</u>	2
<u>Hyrje</u>	4
<u>Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit</u>	5
<u>Kapitulli 2: Objektivat</u>	Error! Bookmark not defined.
<u>Kapitulli 3: Opsionet</u>	37
<u>Nga grupi punues janë trajtuar gjithsej tri opsione për adresimin e problemit të identifikuar më lartë dhe arritjen e objektivave. Këto opsione janë: 1) opsioni asnjë ndryshim; 2) opsioni për për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore; 3) opsioni që parasheh ndryshime ligjore.</u>.....	
<u>3.1: Opsioni asnjë ndryshim</u>	38
<u>3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore</u>	38
<u>3.3: Opsioni i tretë</u>	38
<u>Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme</u>	40
<u>4.1: Ndikimet Ekonomike</u>	40
<u>4.1: Ndikimet Shoqërore</u>	40
<u>Kapitulli 5: Sfidat në mbledhjen e të dhënave</u>	44
<u>Kapitulli 6: Komunikimi dhe konsultimi</u>	45
<u>Kapitulli 7: Krahasimi i opsioneve</u>	47
<u>7.1: Planet e zbatimit për opsionin 3</u>	47
<u>7.2: Krahasimit mes tre opsioneve</u>	48
<u>Kapitulli 8: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm</u>	50
<u>8.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin</u>	51
<u>Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik</u>	51
<u>Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore</u>	53
<u>Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore</u>	55
<u>Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore</u>	56

Përmbledhje e koncept dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti për Mbrojtjen e Konsumatorit
Ministria bartëse	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Personi kontaktues	Nijazi Shala, Udhëheqës i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit Nijazi.Shala@rks-gov.net
PVPQ	Ndërlidhet PVPQ dhe është pjesë e listës së Koncept Dokumenteve për vitin 2021, si dhe në mënyrë të drejtpërdrejt ndihmon në përmbushjen e veprimeve që ndërlidhen me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në R. e Kosovës.
Prioriteti strategjik	Ndërlidhet me prioritete konkrete strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mes tjerash sikurse: - Marrëveshja e Stabilizim Asocimit – NENI 28 (Mbrojtja e Konsumatorit) - Kapitulli 6 i <i>acquis-së</i>: Lëvizja e lirë e mallrave - Draft Programin Qeveritar për Mbrojtjen e Konsumatorit (2021-2025)

Vendimi	
Çështjet kryesore	- Analiza paraprake identifikon që një numër i dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, nuk mbështeten nga masa adekuate administrative dhe/ose dispozita penale. Ndryshimi i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit ka për qëllim të mbështetjen e dispozitave të veçanta të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit me masa e nevojshme/duhura administrative ose dispozitat penale, për te arritur kështu një efikasitet të plotë të kornizës legjislativë të mbikëqyrjes së tregut në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. - Analiza gjithashtu identifikon nevojën mbi harmonizimin e mëtutjeshëm me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni Evropian, prej se është miratuar ligji 06/L-034 në vitin 2018. Komisioni i BE-së propozoi të fillojë një seri reformash / përmirësimesh në fushën e mbrojtjes së konsumatorit në BE, e cila u eventualisht u kurorëzua me hartimin e Direktivës për zbatimin dhe modernizimin më të mirë të mbrojtjes së konsumatorit (BE / 2019/2161). - Së fundmi, mungesa e legjislacioneve ose mospërshtatja e rregulloreve ekzistuese ndaj kushteve të reja të biznesit mund të përbëjë më tutje një pengesë të konsiderueshme në zhvillimin e tregtisë dhe të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik në Kosovë. Në këtë kontekst, përpos ligjeve tjera që afektojnë drejtpërdrejt fushën e tregtisë aktuale dhe me rëndësi të veçantë, tash e disa vite shohim nevojën për zhvillimin e tregtisë elektronike.
Përmbledhje e konsultimeve	Konsultime do të zhvillohen gjatë procesit të konsultimit paraprak dhe publik të paraparë me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
Opsioni i propozuar	Plotësim Ndryshimi i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Nuk ka (shpenzime te përgjithshme administrative).

Ndikimet ekonomike	Në mbrojtjen e konsumatorit, praktikat e drejta tregtare dhe konkurrencën.
Ndikimet shoqërore	Në mirëqenien e përgjithshme publike dhe qytetare.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta në këtë kategori.
Ndikimet ndër-sektoriale	Institucione juridike, administrative shtetërore, publiko-private, donator, OJQ, biznese publike dhe private.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Mund të ketë ndikime.

Hapat e ardhshëm	
Afatmesëm	Plotësim Ndryshimi i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit.
Afatgjatë	Zbatimi në mënyrë me efikasitet të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit – fuqizimi i konsumatorëve si e drejtë elementare, fuqizimin e një mjedisi të përgjithshëm që i mundëson atyre të shfrytëzojnë edhe më shumë të drejtat dhe të përfitojnë prej tyre, që do të thotë fuqizimin e sistemit në të cilin ata mund të mbështeten dhe që u garanton sigurinë e mallrave dhe shërbimeve, por dhe mbrojtjen efektive të interesave të tyre ekonomike, kur këta vihen në rrezik.

HYRJE

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), në këtë rast Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit është përgjegjëse për hartimin e kornizës ligjore për fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit, duke u bazuar në prioritetet Qeveris se Kosovës dhe respektivisht Programit të Miratuar Qeveritar për Mbrojtjen e Konsumatorit (2021-2025), si dhe qëllimit për të adresuar problemet praktike që shfaqen, njëherë duke ofruar zgjidhje të thjeshtë, të shpejtë dhe me kosto të ulët jashtë gjykatës për mosmarrëveshjet midis konsumatorëve dhe tregtarëve.

Me datë 16/04/ 2021, me numër të protokollit 3060, Sekretarja e Përgjithshëm në MTI, me propozim të DMK, ka formuar grupin punues për hartimin e draftit fillestar të Koncept Dokumentit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Ky koncept është përfshirë edhe në listën e Koncept Dokumenteve për vitin 2021. Qëllimi i këtij Koncept Dokumenti është që të propozoj opsionin më adekuat për të adresuar problemin kryesor të identifikuar nga grupi punues, problem ky që krijon vështirësi në funksionimin e lirë të tregut dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Bazuar në Udhëzuesin dhe doracakun për hartimin e koncept dokumenteve është hartuar ky Koncept Dokument i cili do të propozoj opsionin e rekomanduar nga grupi punues.

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Mbrojtjen e Konsumatorit.
Ministria bartëse	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë – Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit
Personi kontaktues	Nijazi Shala, Udhëheqës i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit. nijazi.shala@rks-gov.net
PVPQ	Ndërlidhet me PVPQ, ndihmon në përmbushjen e veprimeve që ndërlidhen me fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.
Prioriteti strategjik	Ky Koncept Dokument ndërlidhet ngushtë me objektivat Strategjisë për Mbrojtjen e Konsumatorit (2021-2025).
Grupi punues	1. Nijazi Shala – Udhëheqës i grupit (DMK/MTI) 2. Plator Gerdovci (DMK/MTI) 3. Artan Demolli (Departamenti i Industrisë/MTI) 4. Albina Bujupi (Departamenti Tregtisë/MTI) 5. Besarta Binaku (Zyra e Financave/MTI) 6. Lindita Rashiti (Inspektorati i Tregut/MTI) 7. Selviqe Çeku (Departamenti Ligjor/MTI) 8. Dardan Nallbani (Departamenti për Integritet./MTI) 9. Selatin Kaçaniku (OJQ – OK Konsumatori) 10. Shkurte Krasniqi (Sekretariati Koordinues i Qeveris) 11. Zana Radoniqi (Ministria e Financave) 12. Njomza Sejdullahu (Zyra Ligjore e Qeveris)
Informata shtesë	Nuk ka informata shtesë

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Mbrojtja e konsumatorëve, për çdo shtet a shoqëri të organizuar, jo vetëm që është një sferë dhe problematikë me rëndësi të veçantë, por edhe komponentë relevante me ndikim të përhershëm në ecuritë dhe kahet e zhvillimit ekonomik e shoqëror. Angazhimi i faktorëve kompetentë në avancimin e pozitës dhe të drejtave të konsumatorëve, do të thotë, jo vetëm shlyerje e një detyrimi ligjor dhe institucional, por qytetërues dhe human.

Mbrojtja e konsumatorëve, së këndejmi, ka të bëjë me krijimin e një ambienti të sigurt, rrjedhimisht të një garancie shoqërore, se të gjitha produktet dhe artikujt, të cilët ata dëshirojnë t'i blejnë, për nevojat ekskluzive të tyre dhe të familjeve të tyre, janë cilësore dhe të sigurt. Mbrojtja e konsumatorëve nënkupton edhe mbrojtjen e drejtë, të plotë, gjithëpërfshirëse dhe adekuate të-të drejtave të konsumatorëve, si në sferën e arsimimit, edukimit, informimit, por edhe në sfera të tjera dhe nga shkaqe, ndikime, veprime mashtruese, substanca dhe faktorë të ndërlikuar, të cilët në përditshmërinë e konsumatorit, kanë potencial të rrezikojnë dhe dëmtojnë jetën, shëndetin, ambientin dhe familjen e tij.

Shkalla e zhvillimit të-të drejtave të konsumatorëve, parimisht është rrjedhojë dhe rezultat i një shkalle të caktuar në rrethana dhe ambient të caktuar të zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik dhe social të një vendi, që do të thotë është karakteristikë e vendeve të zhvilluara dhe demokratike. Mbrojtja e konsumatorëve paraqet një fushë jashtëzakonisht dinamike në Bashkimin Evropian, që predisponon shumë shpesh masa të reja, dhe kjo paraqet arsye të mjaftueshme për të vepruar bashkërisht nga të gjitha autoritetet kombëtare (qeveritare dhe joqeveritare) të sferës së mbrojtjes së konsumatorëve.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë paraqet njërën nga organet publike në formë institucionesh kyçe në relacion me mbrojtjen e të drejtës së konsumatorit. Vetë Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit përmbush rolin e një koordinatori qendror krahas fushave të ndryshme që ndërlidhen apo paraqesin ndikim direkt apo indirekt krahas respektimit të konsumatorit vendor, si në aspektin e hartimit të politikave, njësoj kur kemi të bëjmë me hartimin e kornizës ligjore të kësaj fushe. Për më tepër, përveç Divizionit për Infrastrukturë të Cilësisë, pjesë e Departamentit të Industrisë (njëherësh koordinatori i këtij rrjeti), Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dihet se mbulon katër shtylla tjera, komponentë të rëndësishme të infrastrukturës së cilësisë, që njëherësh afekton sigurimin e një cilësie më të lartë kundruall respektimit të së drejtës së konsumatorëve në tregjet e Kosovës (respektivisht ndaj konsumatorit kosovar), sikurse:

1. Mbikëqyrja e Tregut (Inspektorati): që merret me mbikëqyrjen e tregut, njëherësh zbatimin e praktikave të drejta ndaj konsumatorit.
2. Standardizimi (Agjencia e Standardizimit): është organ kombëtar që miraton standarde dhe harmonizon ato në mënyrë që të krijojë bazë për konkurrueshmëri në rajon dhe më gjerë.
3. Metrologjia: kryen verifikimin, testimin dhe kalibrimin e mjeteve matëse në Kosovë, siç janë njehsorët elektrikë, mjetet matëse të masës, termometrat, voltmetrat, si dhe kryen kontrollimin e cilësisë së punimeve nga metalet e çmuara.
4. Akreditimi (Drejtoria e Akreditimit): është organ kombëtar, i cili në përputhje me standardet ndërkombëtare vlerëson kompetencat teknike të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit, që kryejnë aktivitete siç janë: testim, kalibrim, certifikim dhe inspektim, qofshin në sektorët publikë apo privatë.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë paraqet gjithashtu ombrellë mbi sektorë tjerë të cilët, si koordinatori, në mënyrë direkt apo indirekt përmes legjislaturës sektoriale, mund të

ndikojnë kundruall ofrimit të produkteve apo shërbimeve me cilësore në tregun e Kosovës, këtu veçanërisht përfshihen industria, ndërmarrësia dhe tregtia.

Referuar Rregullores 29/2012, në bazë të së cilës funksion Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, bartës kryesor për hartimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorit në Kosovë, janë Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, respektivisht Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit, duke iu referuar gjithashtu rekomandimeve nga Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit (dhe respektivisht Programit të hartuar nga ky Këshill), ku pretendohet të përfshihen palët e interesit. Objektivi kryesor i politikës 2021 – 2025, për mbrojtjen e konsumatorit paraqet zhvillimin e mëtutjeshëm të mbrojtjes së konsumatorit, që me këtë rast mbështetet në:

- 1) Harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit, që në rastin konkret ka të bëjë me:
 - Propozimin e masave ligjore me qëllim të sigurimit të një shkalle të lartë të mbrojtjes së interesave ekonomike të konsumatorëve, sigurisë së jetës, shëndetit dhe të drejtave të konsumatorëve;
 - Identifikimin e mungesës së legjislacionit për fusha specifike; Harmonizimi i rregullativës ligjore me legjislacionin e BE-së (“*Aquis*”).
- 2) Forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm i kapaciteteve administrative
 - Rritja dhe trajnimi i stafit administrativ, i cili do të jetë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave, edukimin, informimin dhe vetëdijësimin e konsumatorëve
- 3) Informimin dhe edukimin e konsumatorëve
 - Sigurimin e informacionit dhe ndërgjegjësimin publik për të drejtat e konsumatorëve në Kosovë;
 - Aktiviteteve promovuese në të gjitha nivelet, përfshi ato mediatike;
 - Vetëdijësimin e konsumatorëve lidhur me rolin e tyre në treg dhe përfshirjes së tyre në aktivitete institucionale dhe në asociacione të konsumatorëve;
 - Mbështetja e krijimit dhe funksionimit të shoqatave dhe këshillimoreve për mbrojtjen e konsumatorëve, vetëdijësimin dhe edukimin e konsumatorëve;
 - Implementimin e programeve mësimore lidhur me mbrojtjen e konsumatorëve në arsimin parashkollor, fillor, të mesëm dhe superior.

Pra siç po shihet, ndër synimet kryesore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në krijimin e politikave të mirëfillta për mbrojtjen e konsumatorit janë përafrimi i legjislacionit vendor me atë Evropian, duke filluar nga Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit, pastaj edhe ligjeve të tjera që në një mënyrë apo tjetër rregullojnë fushën e mbrojtjes së konsumatorit.

Kur kemi të bëjmë ne përgjithësi me infrastrukturën legjislative aktuale në Kosovë, duhet të përmendet fakti se, është kryer një punë mjaft e madhe që adresohen zbatimin e plotë të së drejtës së konsumatorëve. Gjithsesi, referuar planit të punës të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit për vitin 2021, ndër tjerash, është paraparë edhe koncept dokumenti për Mbrojtjen e Konsumatorit, kryesisht për qëllim të:

1. Harmonizimit të mëtutjeshëm me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni Evropian, prej se është miratuar ligji 06/L-034 në vitin 2018;
2. Harmonizimi dhe plotësimi i boshllëqeve në relacion dispozitave ndëshkuese, për shkak se me kalimin e kohës janë evidentuar mangësi dhe mospërputhje me dispozitat nga Ligji;
3. Implementimin e politikave të reja për mbrojtjen e konsumatorit, sikurse kur kemi të bëjmë me ‘tregtinë elektronike’.

Tabela 1: Dokumentet përkatëse të politikave për mbrojtjen e konsumatorit MINT

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni (-et) shtetëror (e) përgjegjës (e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
Marrëveshja e Stabilizim Asocimit mes R. Kosovës dhe BE-s.	Neni 81 i Marrëveshjes	MINT - DMK	Zbatimi i Marrëveshja e Stabilizim Asocimit mes R. se Kosovës dhe BE-s.
Raportet periodike të Vlerësimit mbi shkallen e Transpozimit të <i>Aquis</i> mbi Mbrojtjen e Konsumatorit në Legjislaturën e Kosovës	Projekti Tregti e Lire e Mallrave i BE-s në MINT (që nga viti 2015)	MINT - DMK	Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit mes R. së Kosovës dhe BE-s.
Programi për mbrojtjen e konsumatorit 2016-2020 Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2021-2025.	http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI_PER_MBROJTJEN_E_KONSUMATORIT_2016-2020.pdf	MTI – DMK – Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit	Implementimi i prog. nga DMK dhe Këshilli; MINT është sponsorizues i kornizës ligjore.
DIREKTIVA 2019/2161 (BE) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (27 Nëntor 2019)	https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32019L2161&from=EN	MINT - DMK	Zbatimi dhe implementimi Direktivës nga Qeveria e Kosovës (me këtë rast MINT/DMK)
PKZMSA	Plani PKZMSA	MINT (DMK/D. Integritet/D. Ligjor) – Ministria për Integritet	Zbatimi dhe implementimi i PVPQ
PVPQ	Plani PVPQ për 2020	MINT (DMK/D. Integritet/D. Ligjor) – Ministria për Integritet	Zbatimi dhe implementimi i PVPQ
Objektivat e MINT 2021	Plani i punës - DMK për vitin 2021	MINT - DMK	Zbatimi dhe implementimi i objektivave të MINT dhe respektivisht Planit të punës së DMK

1. Harmonizimit të mëtutjeshëm me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni Evropian, prej se është miratuar ligji 06/L-034 në vitin 2018, synon harmonizimit me ligjet dhe rregulloret e tjera që kanë të bëjnë me fushën dhe çështjet e mbrojtjes së konsumatorit, respektivisht sjellja në harmonizim me plotësimin e direktivave ekzistuese të BE-s, dhe/apo Direktivave të tjera reja të Bashkimit Evropian, prej se kur është miratuar Ligji 06/L-034 për mbrojtjen e konsumatorit mes tjerash: 85/374/EEC; 2002/65; 2008/122/EC; 2011/83/EU; 2013/11 / EU; 524/2013; 93/13; 1999/44; 1005/29/EC; 2008/48/EC; 2009/22; 90/314/EEC

2. Harmonizimi dhe plotësimi i boshllëqeve në relacion dispozitave ndëshkuese, për shkak se me kalimin e kohës janë evidentuar mangësi dhe mospërputhje me dispozitat nga Ligji, si dhe për faktin që në vitin 2018, Komisioni i BE-së propozoi të fillojë një seri reformash / përmirësimesh në fushën e mbrojtjes së konsumatorit në BE, e cila u eventalisht u kurorëzua me hartimin e Direktivës ‘për zbatimin dhe modernizimin më të mirë të mbrojtjes së konsumatorit’ (BE / 2019/2161), e cila përfundimisht u miratua nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në 27 nëntor 2019. Direktiva ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13 / EEC (Kushtet e padrejta të kontratës), 98/6 / EC (Tregtimi i çmimeve), 2005/29 / EC (Praktikat e padrejta tregtare) dhe 2011/83 / EU (Të drejtat e konsumatorit) të cilat trajtohen përmes Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit (06/L-034).

Rregullat aktuale kombëtare për dispozitat ndëshkuese ndryshojnë ndjeshëm në të gjithë Bashkimin Evropian. Në veçanti, jo të gjitha Shtetet Anëtare të BE-s sigurojnë që gjobat efektive, proporcionale dhe dekurajuese mund të vendosen gjerësisht mbi tregtarët përgjegjës për shkelje ose gjerësisht shkelje të një dimension të Unionit Evropian. Direktiva 2019/2161 siguron një qasje të harmonizuar ndaj dispozitave ndëshkuese, si diçka shumë relative me Ligjin e Kosovës për mbrojtjen e konsumatorit, pasi që konsiderohet se përmban defekte teknike në dispozitat aktuale ndëshkuese. Transpozimi i kësaj Direktive mund të ndihmojë në adresimin e kësaj çështje.

3. Mungesa e legjislacionit ose mospërshtatja e rregulloreve ekzistuese ndaj kushteve të reja të biznesit mund të përbëjë më tutje një pengesë të konsiderueshme në zhvillimin e tregtisë dhe të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik në Kosovë. Në këtë kontekst, përpos ligjeve tjera që afektojnë drejtpërdrejt fushën e tregtisë aktuale dhe me rëndësi të veçantë, tash e disa vite shohim zhvillimin e tregtisë elektronike.

Përveç atyre çështjeve të vogla të përfshira brenda ligjit aktual për mbrojtjen e konsumatorit, fusha e tregtisë elektronike (e-tregtia), aktualisht në Kosovë, vazhdon të jetë kryesisht e pambuluar dhe aktualisht duhet të parashihet si parësore. E-tregtia paraqet praktikën më të shpeshtë të kryerjes së punëve në botën moderne, që përmbledh të shumtën e shtyllave të jetës shoqërore si; tregtare, bankare, shëndetësore, drejtësisë... Pra, si një nga llojet e aktiviteteve të biznesit, e-biznesi mbulon gjithë gamën e transaksioneve tregtare, të cilat kryhen plotësisht ose pjesërisht, përfshirë; reklamimet dhe promovimet, marrëdhëniet mes tregtarëve, aktivitetet e shkëmbimeve, blerjet elektronike dhe mbështetjet e proceseve biznesore, sikurse pjesërisht edhe dërgesat përmes internetit – një sistem të hapur të komercializimit që është paraqitur si lloj i tregtisë elektronike.

Direktiva e BE-së për Tregtinë Elektronike (2000/31/EC) e cila është baza e Ligjit Nr. 04/L-094, është tashme 20 vite e vjetër. Që nga ajo kohë, teknologjia dhe praktikat e biznesit kanë përjetuar një transformim dramatik me implikime të rëndësishme për kryerjen e tregtisë elektronike që përfshin mallrat dhe shërbimet. Si pasojë, rregullimi i tregtisë elektronike në të gjithë botën ka evoluar vazhdimisht në mënyrë që të adresojë çështje të reja të cilat janë në

zhvillim. Në këtë drejtim, në dokumentin udhëzues për shembull, Presidenti i Komisionit Evropian, është zotuar që të përmirësojë rregullat e përgjegjësisë dhe të sigurisë së Unionit për platformat, shërbimet dhe produktet digjitale, me një Pako të re të Shërbimeve Digjitale, për të modernizuar rregullat në fuqi që nga viti 2000. Kosova duhet të ndjeke nga afër zhvillimet në këtë drejtim, në procesin e modernizimit të legjislacionit të saj.

Përkufizimi i problemit, shkaqet dhe efektet

Tabela 2: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	1. Ngecje mbi respektimin e plot të drejtës së konsumatorit
Problemi kryesor	- Mos Funksionimi i plot i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit; - Ngecje në politikat Qeveritare për Mbrojtjen e Konsumatorit.
Shkaqet	1. Masat Administrative dhe Dispozitat Ndëshkuese në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit 06/L-034 nuk konsiderohen të kompletuara, respektivisht nuk janë definuar drejt dhe qartë sa duhet. 2. Aktualisht ekziston një vakum ligjor në relacion me harmonizimin e plot me ligjet dhe rregulloret e BE-s për Mbrojtjen e Konsumatorit. Me kalimin e kohës është konstatuar se ka pasur gjithashtu devijim nga parimet e përgjithshme. 3. Në sektorë të veçantë mungon rregullimi dhe zbatimi (përmes inspektorateve kompetente) administrativ, apo në raste të veçanta nuk ekzistojnë fare mekanizma të veçantë për trajtimin të ankesave. 4. Paqartësi në trajtimin e ankesave të konsumatorëve përmes procedurës administrative. 5. Mungon harmonizimi me politikat e BE-s në relacion me marrëveshjen e Stabilizim Asocimit. 6. Gjykata Themelore dihet të ketë qenë e stërngarkuar me konteste. 7. Trajtimi i rasteve përmes Gjykatave Kompetente, shpesh rezulton i kushtueshëm për konsumatorin, apo edhe i pamundur për faktin sepse shumë shkëmbime tregtare sot manifestohen përmes formës elektronike. 8. Mos efikasiteti i sanksioneve nga Inspektoratet përkatëse edhe kur është vërtetuar se ka pasur shkelje të së drejtës së konsumatorëve.

Shkaqet

1. Është krijuar vakum ligjor në relacion me Ligjet dhe Rregulloret e BE-s prej se është miratuar Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit 2018

Analiza 1 – Aktualisht ekziston një vakum ligjor në relacion me politikat e BE-s karshi mbrojtjen e së drejtës të konsumatorit, kjo veçmas sepse në sistemin e R. së Kosovës aktualisht nuk janë të transpozuar Direktiva BE / 2019/2161, si dhe Direktiva 2000/31/EC (për tregti elektronike). Harmonizimi me Ligjet Evropiane, është i nevojshëm për të forcuar besimin e konsumatorëve në tregun e brendshëm, përfshirë në fushën e tregtisë në internet, dhe për të përmbushur potencialin dhe mundësitë e tregtisë ndërkufitare dhe/apo *on-line*. Një zhvillim i tillë konsiderohet se duhet të bazohet në procedurat ekzistuese në Shtetet Anëtare të BE-s dhe të respektojë traditat e tyre ligjore.

2. Në sektorë të veçantë mungon rregullimi dhe zbatimi (përmes inspektorateve kompetent) administrativ, apo në raste të veçanta nuk ekzistojnë fare mekanizma të veçantë për trajtimin e ankesave

Analiza 2. Në shumë sektorë mungon rregullimi dhe zbatimi i plot (përmes inspektorateve kompetent) administrativ, apo në raste të veçanta nuk ekzistojnë fare mekanizma të veçantë për trajtimin e ankesave. Autoritetet si Rregullatorët e Shërbimeve Publike, Banka Qendrore, Autoriteti i Ushqimit dhe Veterinarisë apo Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ofrojnë mekanizëm të brendshëm të ankesave ku konsumatorët mund të drejtojnë ankesat e tyre dhe ku bëhet një vlerësim i brendshëm i ankesave të tyre. Këto mekanizma përdoren zakonisht kur konsumatorët nuk gjejnë një gjuhë të përbashkët me partitë e tyre kryesore kundër një institucioni. Duke qenë se këto ndërmarrje zakonisht kanë numër më të lartë ankesash, shumë herë këto mekanizma nuk i trajtojnë ankesat si duhet nën mungesën e bazës ligjore.

3. Trajtim i njëanshëm i ankesave të konsumatorëve përmes procedurës administrative

Analiza 3: Kur një çështje procedohet në mekanizmin e brendshëm të trajtimin të ankesave, çështja zakonisht trajtohet brenda institucionit ku palët përgjegjëse hetojnë ankesën, dhe pas konsultimeve të brendshme dhe të mundshme të jashtme arrihet një pikëpamje dhe pozicioni institucional i komunikohet konsumatorit. Nëse ankesa përfshin aktorë të tjerë të interesuar, ata gjithashtu mund të konsultohen në mënyrë që të arrihet një pasqyrë më e mirë e ankesës. Përndryshe, ankesat trajtohen si të njëanshme pa u konsultuar dhe nën diskrecionin e autoritetit përkatës. Për këtë arsye është me se e nevojshme zgjerimi i bazës ligjore, njëherësh definimi i saj.

4. Mungon harmonizimi me politikat e BE-s në relacion me marrëveshjen e Stabilizim Asocimit

Analiza 4: Zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit parqet kusht obligator për R. e Kosovës drejt rrugës në BE. Përafrimi në relacion legjislativ të BE-s, mes tjerash, është parashikuar gjithashtu edhe përmes planeve Qeveritare sikurse PVPQ, PKZMSA, Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit, Programit të punës së DMK apo Programit legjislativ nga fusha e mbrojtjes së konsumatorit për vitin 2020.

5. Gjykata Themelore dihet të ketë qenë e stërngarkuar me konteste

Analiza 5: Që nga paslufta e së këtejmi, Gjykata Themelore dihet të ketë qene e stërngarkuar me konteste, ku qeshja e mbrojtjes se konsumatorëve jo gjithherë dihet të jetë adresuar me prioritet. Duke marrë parasysh numrin e inspektorateve shtetërore dhe faktin që gjykatat janë të mbingarkuara vijnë në përfundim që inspektimi shtetëror nuk shfrytëzohet në nivelet e nevojshme.

6. Mos harmonizimi i afateve për shqyrtimin e ankesës me Ligjin për proceduar të përgjithshme administrative (si dhe afati i shkurtër)

Analiza 6: Mbikëqyrja e tregut është paraparë të bëhet nga Inspektorati i Tregut dhe respektivisht organet e tjera mbikëqyrëse jashtë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Disa prej këtyre organeve mbikëqyrëse (sikurse Inspektoratet), ende se kanë arritur shkallshmërinë e duhur të funksionalizimit, respektivisht ende nuk e kanë të mundur të ushtrojnë sa duhet kompetencat e parapara sipas Ligjeve në fushat përkatëse të zbatimit të Ligjeve. Kjo mënyrë e mbikëqyrjes së tregut shpesh ka rezultuar jo efikase ngase inspektorati kompetente apo profesionale në fusha (të ndryshme) përkatëse, për shkaqe të ndryshme nuk është i përfshirë në aktivitet e inspektimit, apo shpesh ndodh që nuk konsiderohen apo janë edhe aq profesionale nën mungesën e kompetencave ligjore, ku shpesh ka pamundësuar zbatimin e parregullive, si dhe ju ka lejuar subjekteve tregtare të veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe mos gjobitjen të tyre.

Efektet

1. Dëmtimi i konsumatorit

Për arsye të kapaciteteve të limituara të stafit të sektorit dhe formës të mbikëqyrjes se tregut dhe infrastrukturës se cilësisë, njëherësh stërngarkimit me lëndë pran gjykatave (kompetente themelore) bazuar në ligjin në fuqi, rezulton në pa mundësinë e kontrollit të cilësisë të së gjitha produkteve dhe shërbimeve në tregun e Republikës së Kosovës. Si pasoje, kjo situatë është duke sjellë gjithherë e më shumë situata në kundërshtim me Ligjet përkatëse, rrjedhimisht duke e dëmtuar konsumatorin. Kjo ndikohet gjithashtu nga vështirësitë me mbikëqyrjen e tregut, sikurse u elaborua gjerësisht më lartë. Konsumatori pra është duke paguar çmim më të lartë që nuk korrespondon me gjendjen reale.

2. Alternativ më e drejtpërdrejt dhe më e shpejt

Përmirësimi i bazës ligjore mund të ofrojë një alternativë më të drejtpërdrejt dhe më të shpejtë për konsumatorin në gjetjen e një zgjidhje për ankesën e tij drejtpërdrejt me biznesin ku është bërë blerja. Sipas vlerësimit të Komisionit Evropian, procedura e zgjedhjes së mosmarrëveshjeve të Konsumatorëve përmes procedurës administrative, në shumicë nuk kalon afatin e 60 dhiteshit për tu zgjidhur.

3. Reagime pozitive nga ana e konsumatorëve nga vendet e BE-s

Reagimet nga konsumatorët në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian kanë tendencë të jenë pozitive. Sondazhi i Komisionit Evropian tregon gjithashtu se shumica e konsumatorëve kanë të drejt në parashtrimin e ankesave të tyre.

4. Alternativ shpesë dhe e jo e komplikuar ku të drejtohet konsumatori

Një numër i madh i ankesave të konsumatorëve nuk zgjidhen. Nga vlerësimet dhe respektivisht të dhënat zyrtare në kuadër të Departamentit për Mbrojtjes së Konsumatorit, thuajse për çdo vite kalendarik mbesin të pazgjedhura deri në 50% të ankesave drejtuar inspektorateve kompetente apo Rregullatorëve në kuadër të ndërmarrjeve publike të cilat kanë mbetur të pazgjidhura. Sistemi gjyqësor mund të jetë një perspektivë shqetësuese dhe e shtrenjtë, dhe prandaj vetëm një pjesë e vogël e këtyre ankesave në të vërtetë arrijnë në gjykatë.

Në vijim, në bazë të të dhënave të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit, tabela e mëposhtme liston ankesat e konsumatorëve sipas sektorëve të veçantë për vitin 2020.

Tabela. 2: Ankesat e konsumatorëve sipas sektorëve të veçantë dhe trajtuar në vitin 2021

Emri i autoritetit dhe numri (totali) i ankesave të pranuar nga DMK	Ankesat e zgjidhura dhe pa-zgjidhura	Totali i trajtimit sipas përqindjes.
Ankesat e kategorisë Energjia Elektrike (ARKEP) – Gjithsejtë: 8 ankesa	Të zgjidhura: 5 Të pa-zgjidhura: 3	Të zgjidhura 62.50%
Ankesat e kategorisë Shërbime Financiare (BQK) – 17	Të zgjidhura: 3 Të pa-zgjidhura: 14	Të zgjidhura 17.65%.
Ankesat e kategorisë Ushqim – 90	Të zgjidhura: 37 Të pa-zgjidhura: 53	Të zgjidhura 41.11%.
Ankesat e kategorisë Shëndetësi – 5	Të zgjidhura: 2 Të pa-zgjidhura: 3	Të zgjidhura 40%.
Ankesat e kategorisë Metrologji – 2	Të pa-zgjidhura: 2	Të zgjidhura 0%.
Ankesat e kategorisë Blerje Online – 22	Të zgjidhura: 14 Të pa-zgjidhura: 8	Të zgjidhura 36.36%.
Ankesat që i jenë drejtuar kategorisë Administrata Tatimore e Kosovës – 8	Të pa-zgjidhura: 8	Të zgjidhura 0%.
Ankesat kategori Telekomunikacion – 134	Të zgjidhura: 32 Të pa-zgjidhura: 108	Të zgjidhura 23.88%.
Ankesat e kategorisë Tregti – 223	Të zgjidhura: 164 Të pa-zgjidhura: 59	Të zgjidhura 73.54%.
Ankesat që i janë drejtuar kategorisë Ujësjiellës (ARRU) – 2	Të zgjidhura: 2	Të zgjidhura 100%.
TOTALI – 511	Të zgjidhura: 253 Të pa-zgjidhura: 258	Të zgjidhura 49.51%.

Kapitulli 2: Objektivat

Qëllimi kryesor i politikës së propozuar është përmirësimi i kornizës ligjore në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, si parakusht për funksionimin e lirë të tregut, mbrojtjen e konsumatorit dhe mundësimin e konkurrencës së drejtë. Me përmirësimin e kornizës ligjore synohet të arrihet përputhshmëri më e lartë me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian. Kjo politikë kontribuon në përmbushjen e prioriteteve të reformave ekonomike dhe institucionale që burojnë nga dokumentet strategjike, përkatësisht ndërlidhja me dokumente relevante, sikurse:

1. MSA (Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit)

Në formën e vet vazhdim i DPSA (Dialogu i Procesit të Stabilizim Asocimit – Mars 2012), MSA reflekton finalizimin e suksesshëm të negociatave mes Kosovës dhe BE-së përmes kësaj marrëveshje të finalizuar në maj të vitit 2014, respektivisht korrik 2014 me inicialet e saj nga ana e Kryenegociatorëve. Ratifikimi i MSA-së nga ana e institucioneve të BE-së dhe përmbyllja / nënshkrimi nga ana e autoriteteve të Kosovës dhe BE-së është realizuar në vitin 2015. Referuar kësaj marrëveshje në mënyrë të drejt-për-drejt apo tërthorazi, mbrojtja e konsumatorit përgjithësisht ndërlidhet me marrëveshjes. Me këtë rast vlen të përmendet Neni 1 i marrëveshjes – fillimisht duke u nisur nga vet synimet e përgjithshme të marrëveshjes. Pastaj, në mënyrë më specifike edhe në titullin IV të marrëveshjes ('Përafrimi i ligjit të Kosovës me *acquis* të BE-së, Zbatimi i Ligjit dhe Rregullat e Konkurrencës'), konkretisht pastaj nenin 28, ku shprehimisht ceket Mbrojtja e Konsumatorit, mbështetur në parimet:

- a. Një politikë për mbrojtjen aktive të konsumatorëve, në përputhje me të drejtën e BE-së, duke përfshirë rritjen e informimit dhe zhvillimit të organizatave të pavarura në Kosovë;
- b. Harmonizimin e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorit në Kosovë me atë ekzistues në BE;
- c. Mbrojtjes efektive ligjore për konsumatorët në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mallrave të konsumit dhe ruajtjen e standardeve të duhura të sigurisë;
- d. Monitorimin e rregullave nga autoritetet kompetente dhe siguri i qasjes së kompensimit përkatës ligjor në rastet e mosmarrëveshjeve;
- e. Shkëmbimi i informatare mbi produktet e rrezikshme.

2. Plani Kombëtar për adoptimin e *acquis*

Zbatimi i MSA-së ka kërkuar reforma më gjithëpërfshirëse të sistemit ekonomik dhe politik në Republikën e Kosovës. Këto reforma dhe harmonizimi i legjislacionit vendas me *acquis*-in e BE-së kërkojnë angazhimin e të gjitha institucioneve në Kosovë. Procesi i përmbushjes së detyrimeve për përshtatje me kushtet për anëtarësim të *asociuar* ka qenë që nga fillimi i lidhur me procesin e rregullimit të sistemit të përgjithshëm ndaj kriterëve për anëtarësim të plotë. Për të arritur këtë objektiv është e nevojshme për të zhvilluar një kornizë të përgjithshme strategjike kombëtare për integrimin në BE për të arritur gradualisht përafrimin me BE-në në të gjithë nivelet.

Në këtë aspekt, Qeveria e Kosovës ka përgatitur Programin Kombëtar të Republikës së Kosovës për Aproximin e Acquis të Bashkimit Evropian (PKAA). Fushëveprimi i tij parashihet si shumë më i gjerë sesa dokumentet aktuale strategjike qeveritare deri më tani. PKAA parashihet si një dokument i përgjithshëm gjithëpërfshirës dhe udhëzues i Qeverisë së

Republikës së Kosovës në procesin e saj të anëtarësimit evropian, duke filluar nga zbatimi i MSA-së, dhe vazhduar me qëllimin e tij për të aplikuar për statusin e vendit kandidat, dhe deri tek anëtarësimi aktualë i vendit në BE. PKAA në vete përmban edhe kapitull të veçantë që ka të bëjë me aspektin e Mbrojtjes së Konsumatorit, me konkretisht, kapitulli 28: Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndetit. Me datën 23/07/2015, u mbajt takimi për hartimin PKAA, ku u shpalosen objektivat në relacion me adoptimin aquis Evropiane mbi të drejtën e Konsumatorit, që në vetvete janë në përputhje të plot me objektivat e këtij koncept dokumenti, pra plotësimi i legjislacionit Kosovar në përputhje me Direktivat Evropiane karshi Mbrojtjes së Konsumatorit.

3. Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit

Programi i kaluar për Mbrojtjen e Konsumatorit i cili ka kaluar procesin e miratimit (periudha 2016 – 2016), njëherësh dhe Programi 2021-2025 i cili është në fazën e miratimit në Qeveri, ka paraparë implementimin efektiv të legjislacionit, respektivisht transpozimin e të gjitha direktivave Evropiane që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorit. Për më shumë, programi 2016-2020 gjithashtu ofron opsionin e parashikimit kur kemi të bëjmë me transpozimin e *aquis* nga fushat relevante karshi Mbrojtjes së Konsumatorit.

Tabela 3: Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Strategjik - Zhvillimi i mëtejshëm i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Infrastrukturës së Cilësisë	<i>Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit (2016 – 2020)</i> <i>MSA, PKAA, PVPQ, PKZMSA</i> <i>Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2019-2021</i>
Specifik - Përafrimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit.	<i>Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2016 -2020</i> <i>MSA, PKAA, PVPQ, PKZMSA</i>
Specifik - Ngritja e kapaciteteve në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit.	<i>Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit 2016 -2020</i> <i>MSA, PKAA, PVPQ, PKZMSA</i>
Specifik – Ngritja e vetëdijes për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe infrastrukturën e cilësisë.	<i>Programi për Mbrojtjen e Konsumatorit (2021 – 2025)</i> <i>MSA, PKAA, PVPQ, PKZMSA</i> <i>Strategjia për Zhvillimin e Sektorit Privat 2019-2021</i>

4. Projekti Tregti e Lire e Mallrave - BE

Përgjatë procesit të hartimit të koncept dokumentit, përmes projektit 'Tregti e Lirë e Mallrave' të Komisionit Evropian në Kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, për qellim ekspertize, është ofruar ndihma e analisteve, rrjedhimisht ku dihet të janë ofruar rekomandime shtesë mbi mangësitë në relacion me *aquis*, respektivisht legjislacionin e Bashkësisë Evropiane krahas të së drejtave të konsumatorëve. Implementimi i pjesërishëm apo plot i rekomandimeve parashihet të rezultojë në një plotësim ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, që me këtë rast është paraparë si i arsyeshëm konkretisht për vitin 2021.

Objektivat

Rezultat i rekomandimeve sikurse figurojnë më lart, aspektet kryesore për tu adresuar parashihen:

- 1) Harmonizimi i mëtutjeshëm i Legjislacionit Evropian;
- 2) Harmonizimi dhe plotësimi i boshllëqeve në relacion masat administrative dhe dispozitave ndëshkuese;
- 3) Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit.

1) Harmonizimi i mëtutjeshëm me Legjislacionin Evropian

I. Në baze të raportit 'Vlerësimi i kreut XV mbi veprimtarin kolektive në kuadër të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit' (miratuar në vitin 2018), realizuar nga eksperti i angazhuar përmes projektit 'Tregti e Lirë e Mallrave' të BE-s në MTI vitin 2019. Në bazë të këtij raporti, mund të kuptohet se, në relacion me Direktivën Evropiane, ekzistojnë thjesht disa ndryshime të vogla, njëra prej së cilave mund të konsiderohet si thelbësore.

Më tutje, ekspertiza potencon se kërkesat kolektive për masa duhet të jenë në përputhje me Direktivën e BE-s – ngritur nga subjekte të kualifikuara, zakonisht organizata të konsumatorëve, ku ligjet kombëtare mund të përcaktojnë kërkesa shtesë (p.sh.: që kanë ekzistuar për një periudhë të caktuar kohe dhe janë realisht funksionale; grupe *ad-hoc* konsumatorësh që kanë personalitet juridik, formuar/krijuar posaçërisht për shkakun e ndjekjes së një shkelje të caktuar, apo; organizatave autonome të tregtisë kur ndonjëherë u jepet gjithashtu statusi i një subjekti të kualifikuar që ka të drejtë të ndërmarrë masa të masave të ndalimit).

Referuar rekomandimit, numri kufizues i subjekteve të kualifikuara duhet të sigurojë një cilësi të caktuar të përgatitjes së padisë dhe ndjekjen e saj në gjykatë. Pastaj, duhet të merret gjithashtu parasysh se në lidhje me një shkelje, vetëm një kërkesë kolektive për ndalim mund të ngrihet kundër të njëjtit tregtar. Prandaj, rekomandohet se është e një rëndësie të jashtëzakonshme që kërkesat kolektive për ndalimin e masave duhet të përgatiten me kujdes dhe të sillen vetëm nga subjekte të kualifikuara, të afta për të mbrojtur në mënyrë adekuate interesat kolektive të konsumatorëve. Mundësia që çdo individ (qoftë edhe kur është përfaqësues i tregtarit) për të sjellë masën e ngritjes së përkohshme nuk garanton një cilësi të tillë, dhe hap rrezikshmëri për një abuzim të mundshëm.

Përfundimisht, rekomandimi i ekspertit është qe: Mundësia që padia kolektive të ngrihet nga një individ 'në emër të interesit kolektiv' duhet të fshihet (neni 119, paragrafi 4), dhe se vetëm entitetet e kualifikuara (organizatat e certifikuar të konsumatorëve dhe shoqatat tregtare, të cilat mbulojnë sektorin për të cilin ka të bëjë shkelja) duhet të kenë opsionin për të ngritur veprime kolektive për lehtësim të detyrueshëm.

Referuar vlerësimi të mëtutjeshëm të kreut XV mbi veprimtarin kolektive në kuadër të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, ekzistojnë edhe dispozita të tjera të cilat duhet ndryshuar apo përshtatur (p.sh. neni. 122, pika, ku 'ndërhyrësi', duhet zëvendësuar me 'intervenuesi'), pasi shtrembërojnë kuptimin e vërtetë (original) të ligjit. Përndryshe, kuptimi i duhur lehtë mund të humbet.

Rekomandimi përfundimtar i ekspertit: I gjithë kapitulli duhet të rishikohet. Përshtatja e versionit (në Anglisht dhe anasjelltas) të Kapitullit XV të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit është e domosdoshme.

II. Raportit 'Mbështetje mbi Lëvizjen e Lirë të Mallrave në Kosovë (mbështetje nga projekti i Bashkimit Evropian) – Rishikimi i përputhshmërisë së Ligjit të Kosovës për mbrojtjen e konsumatorit' 06/L-034, vlerëson transpozimin e akteve të BE-së dhe gjykon nëse këto akte juridike janë pasqyruar në mënyrë korrekte. Raporti nuk komenton mbi dispozitat e Ligjit që janë jashtë fushës së Direktivave Evropiane të transpozuara në Ligjin 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit (gjithsejtë dhjet direktiva), të cilat u shtuan si masa kombëtare të zbatimit, ose si dispozita shpesh kombëtare.

Shembuj të këtyre dispozitave (listë jo kufizuese) jo në përputhshmëri apo të plot (apo që nuk lejohet të devijojnë) nga Direktivat Evropiane, paraqesin:

2.1 Direktiva 2002/65 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 Shtatorit 2002 në lidhje me tregtimin në distancë të shërbimeve financiare të konsumatorit.

Neni 12 - Natyra esenciale:

"Konsumatorët nuk mund të heqin dorë nga të drejtat e tyre që ua jap kjo Direktivë" Ky fakt nuk është adresuar në Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit (LMK) dhe është një çështje e cila duhet të adresohet.

2.2 Direktiva 2005/29 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 maj 2005 në lidhje me praktikën e padrejta tregtare nga biznesi të konsumatorit në tregun e brendshëm.

Neni 7 - Mangësitë mashtruese

Neni 7.5 i referohet Aneksit II, konkretisht një listë jo-kufizuese të akteve të tjera të BE-së që kanë kërkesa specifike në lidhje me reklamimin (shembull: reklamimi për produktet medicinale). Rekomandohet që MTI duhet të publikojë një listë të ngjashme, kjo do të mbështetet nga projekti FMG.

Neni 11 - Zbatimi

Zbatimi përmes neneve 135 dhe 136 të LMK nuk konsiderohet i plotë. Në veçanti udhëzimet specifike për eliminimin e efekteve të vazhdueshme të praktikave të padrejta tregtare nuk janë marrë në konsideratë në mënyrë të qartë.

Neni 13 - Dënimet

Fakti se nuk janë parashikuar dispozita ndëshkuese për shkeljet, kjo duhet të adresohet. Kjo mund të arrihet duke shtuar një referencë në Nenet 9 dhe 10 të LMK në dispozitat ndëshkuese (Kapitulli XIX – LMK).

2.3 Direktiva 2006/114 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 12 Dhjetorit 2006 në lidhje me reklamën mashtruese dhe krahasuese.

Neni 2 - Përkufizimet

Rekomandohet përkufizim për "reklamën krahasuese"

Neni 4 - Reklamimi krahasues

Dispozitat për reklamimin krahasues janë mbuluar vetëm pjesërisht përmes Nenit 9.3.1 të LMK. Rekomandohet që ky Nen të zgjerohet për të përfshirë dispozitat e plotë të Direktivës 2006/114 / EC

Neni 8 - Kufizime të tjera

Rekomandohet që Kosova mund të parashikojë kufizime të tjera në reklamim. Për këtë duhet kontaktuar EUOK-un në lidhje me këto dispozita, nëse ato ekzistojnë ose janë hartuar.

2.4 Direktiva 2008/48 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 Prillit 2008 mbi marrëveshjet e kredisë për konsumatorët.

Neni 13 – Marrëveshjet përfundimtare për kreditë e hapura

Zbatuar përmes Nenit 94 LMK, megjithëse përcaktohen "Arsyet e objektivave të arsyeshëm" (të kufizuar në këtë mënyrë): përdorimi i paautorizuar ose mashtrues i kredisë rrit rrezikshmërinë që klienti nuk do të jetë në gjendje të paguajë kredinë.

Neni 19 - Llogaritja e përqindjes vjetore të tarifës - Zbatuar përmes Nenit 100 LMK
Duket se neni 19, paragrafi 5 (referuar pretendimeve të përcaktuara në Aneksin I përdorur për llogaritjen e përqindjes vjetore të tarifës) nuk është transponuar: formula e BQK-së për llogaritjen e përqindjes vjetore të tarifës është ndryshe nga ajo e përshkruar në Direktivë. Së dyti, Rregullorja e BQK-së u drejtohet vetëm bankave përderisa edhe entitetet e tjera si shitësit me pakicë ofrojnë kredi për konsumatorë.

2.5 Direktiva 2008/122 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 janar 2009 mbi mbrojtjen e konsumatorëve në lidhje me 'Kontratat e Përdorimit të Pushimit me Afat, të Produktit të Pushimit Afatgjatë, të Rishitjes dhe të Shkëmbimit'

Neni 2 - Përkufizimet

Neni 3 i LMK nuk përmban një përkufizim specifik për "Kontratat Ndihmëse"

Neni 11 - Përfundimi i kontratave ndihmëse

Neni 114 LMK i referohet gabimisht nenit 86 LMK, duhet të jetë neni 96 LMK

Art 15 - Dënimet

Asnjë dënim nuk është paraparë me LMK, kjo duhet të adresohet.

Shtojca I - V

Këto kërkohej publikimi udhëzimeve specifike administrative. Propozimet janë transmetuar nga projekti 'FMG' të MTI, botimi është planifikuar për në Qershor 2019.

2.6 Direktiva 2011/83 / BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2011 mbi të drejtat e konsumatorit

Neni 2 - Përkufizimet

Neni 3 i LMK nuk përmban përkufizime për "Mallrat" dhe as "Kontratën e Shitjes"

Neni 3 - Fushëveprimi

Nuk është transponuar si duhet: Neni 3.3 rendit përjashtime nga qëllimi, këto merren nga Neni 37, i cili zbatohet vetëm për kontratat në distancë dhe jashtë zyrave afariste. Kjo do të duhet të adresohet pasi do të thotë që dispozitat e LMK janë të zbatueshme

gjithashtu për kontrata të tilla si lojërat e fatit ose paketat turistike, të cilat janë jashtë fushës së zbatimit të 2011/83 / EU.

Neni 8 - Kërkesat zyrtare për kontratat në distancë

Transponuar përmes Nenit 41 LMK. Neni 8.9 i Direktivës 2011/83 / BE i referohet Direktivës së Tregtisë Elektronike (2000/31 / EC), e cila nuk është e mbuluar nga LMK.

Neni 11 - Ushtrimi i së drejtës së tërheqjes

Transponuar përmes Nenit 44 LMK. Kjo kërkon botimin e udhëzimeve specifike administrative. Propozimet janë transmetuar nga projekti FMG te MTI.

Neni 15 - Efektet e ushtrimit të së drejtës së tërheqjes në kontratat ndihmëse

Zbatuar përmes Nenit 48 LMK. Kjo kërkon botimin e udhëzimeve specifike administrative. Propozimet janë transmetuar nga FMG te MTI.

Neni 27 - Shitja e inercisë

Këto dispozita nuk janë miratuar. Kjo duhet të adresohet.

2.7 Statusi mbi hartimin e mëtutjeshëm të legjislacionit sekondar për Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit

#	Subjekti	Statuti
1	Akti nënligjor mbi kërkesat shitesë të informacionit për etiketimin (neni 16.8)	Çështja e flamurit, Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 20/2018 Për përcaktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të flamurit në origjinën e Produktit (29.12.2018) Shënim: KE e rekomandoj MTI-në me një përmbledhje krahas ligjshmërisë së nenit 16.8, si dhe U.A.(jo në përputhje me Acquis).
2	Udhëzim administrativ për procedurën e trajtimit të ankesave nga departamenti i mbrojtjes së konsumatorit	Udhëzim Administrativ (MTI) nr. 13/2018 Për procedurën e trajtimit të ankesave nga departamenti i mbrojtjes së konsumatorit (13.11.2018). Shënim: U. A. të tjera janë të nevojshme, pasi struktura organizative themelore ende duhet të zhvillohet.
3	Udhëzim administrativ mbi strukturën ligjore të autoriteteve për mbrojtjen e konsumatorit.	Struktura nuk është përcaktuar qartë, kështu që U.A. në fjalë nuk mund të hartohet ende.
4	Akti juridik që siguron një listë të ligjeve të Kosovës në lidhje me komunikimin komercial (Neni 10.5)	Rregullore të ndryshme specifike të produkteve gjithashtu imponojnë kërkesa për etiketim. Shënim: FMG do të mbështesë hartimin e një U.A. që obligon MTI-në të publikojë dhe mirëmbajë një listë të kërkesave të tjera.
5	Regjistri i NGO-ve të dëshmuara për mbrojtjen e konsumatorit.	Vendimi i 77-të i mbledhjes së qeverisë të 3 dhjetorit mbi përbërjen e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit.

III. Në vitin 2018, Komisioni i BE-së propozoi të fillojë një seri reformash / përmirësimesh në fushën e mbrojtjes së konsumatorit në BE. Kjo iniciativë u etiketua "Marrëveshje e Re për Konsumatorët". Pas këtyre propozimeve, Direktiva për zbatimin dhe modernizimin më të mirë të mbrojtjes së konsumatorit të BE (BE / 2019/2161) u miratua nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në 27 nëntor 2019. Direktiva ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13 / EEC (Kushtet e padrejta të Kontratës), 98/6 / EC (Tregimi i Çmimeve), 2005/29 / EC (Praktikat e padrejta të tregtare) dhe 2011/83 / EU (Të Drejtat e Konsumatorit) të cilat trajtohen përmes Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit (06/L-034).

Për të arritur qëllimet e mësipërme, 'Marrëveshja e Re për Konsumatorët' propozon ndryshime në kornizën legislative të plotësuar nga një sërë veprimesh jo-legjislative. Paketa legislative përbëhet nga dy instrumentet e mëposhtëm:

- Një direktivë që ndryshon Direktivën e Këshillit 93/13 / EEC, Direktivën 98/6 / EC, Direktivën 2005/29 / EC dhe Direktivën 2011/83 në lidhje me zbatimin dhe modernizimin më të mirë të rregullave të BE-së për mbrojtjen e konsumatorit;
- Një direktivë mbi veprimet përfaqësuese për mbrojtjen e interesave kolektive të konsumatorëve dhe shfuqizimin e Direktivës 2009/22 / EC. Ky propozim synon të lehtësojë dëmshpërblimin për konsumatorët kur shumë konsumatorë janë viktimë e të së njëjtës shkelje, në një situatë të ashtuquajtur dëm masiv.

Direktiva për zbatimin dhe modernizimin më të mirë të mbrojtjes së konsumatorit të BE (BE / 2019/2161) u miratua nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në 27 nëntor 2019. Ndërsa, shtetet anëtare të BE-s duhet të miratojnë dhe publikojnë masat e nevojshme për të qenë në përputhje me këtë Direktivë deri më 28 Nëntor 2021. Ata duhet t'i zbatojnë ato masa nga 28 maj 2022. Në praktikë, 'Marrëveshja e Re për Konsumatorët' synon:

- Modernizimin e rregullave ekzistuese dhe plotësimin e boshllëqeve në legjislacionin aktual të konsumatorit;
- Mundësi më të mira dëmshpërblimi për konsumatorët, zbatim efektiv dhe bashkëpunim më të madh mes autoriteteve publike në një treg të përbashkët të drejtë dhe të sigurt;
- Rritjen e bashkëpunimit me vendet partnere jashtë BE-së;
- Trajtim të barabartë të konsumatorëve në tregun e vetëm dhe garanci që autoritetet kombëtare kompetente janë të autorizuar të trajtojnë çdo problem me 'cilësinë e dyfishtë' të produkteve të konsumit;
- Përmirësimin e komunikimit dhe ndërtimin e kapaciteteve për t'i bërë konsumatorët më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe për të ndihmuar tregtarët, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që të veprojnë më lehtë me detyrimet e tyre;
- Parashikimin e sfidave të ardhshme për politikën e konsumatorit në një mjedis ekonomik dhe teknologjik që zhvillohet shpejt.

Direktiva paraqet ndryshimet e mëposhtme.

- **Masat e harmonizuara të zbatimit** – Rregullat aktuale kombëtare për dispozitat ndëshkuese ndryshojnë ndjeshëm në të gjithë Bashkimin Evropian. Në veçanti, jo të gjitha Shtetet Anëtare të BE-s sigurojnë që gjobat efektive, proporcionale dhe dekurajuese mund të vendosen gjerësisht mbi tregtarët përgjegjës për shkelje ose gjerësisht shkelje të një dimension të Unionit Evropian.
 - o Direktiva 2019/2161 siguron një qasje të harmonizuar ndaj dispozitave ndëshkuese, si diçka shumë relative me Ligjin e Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorit, pasi që konsiderohet se ka defekte teknike në dispozitat aktuale ndëshkuese në këtë Ligj. Transpozimi i kësaj Direktive mund të ndihmojë në adresimin e kësaj çështje.
- **Transparenca e tregut (apo tregjeve) në internet** – Sot, kur konsumatorët blejnë në tregun e elektronik (internet), ata nuk e dinë gjithmonë se nga kush blejnë produktin ose shërbimin (i.e. një tregtar profesionist ose një konsumator tjetër).

Mosnjohja e identitetit të furnizuesit paraqet një problem sepse nëse diçka nuk shkon si duhet, rregullat e mbrojtjes së konsumatorit nuk zbatohen kur blihet nga një individ tjetër privat. Rregullat e reja e bëjnë më të lehtë për konsumatorët të vlerësojnë rreziqet kur bëjnë pazare në treg (apo tregje) në internet.

Ne këtë mënyrë, parashihet që tani e tutje konsumatorët do të informohen nëse personi që shet mallra ose shërbime në internet është një tregtar ose një individ tjetër privat, dhe paralajmëron që rregullat e BE-së për mbrojtjen e konsumatorit nuk zbatohen kur furnizuesi nuk është tregtar. Tregu në internet parashihet që gjithashtu të tregojë nëse furnizuesi ose vetë tregu është përgjegjës p.sh. për dorëzimin ose për trajtimin e kthimeve nën të drejtën e tërheqjes.

Konsumatorët gjithashtu do të dinë se ku të drejtohen në rast të problemeve

Direktiva gjithashtu ofron një kornizë të përmirësuar në:

- Të drejtat e konsumatorit për shërbime dixhitale “falas”;
- Statusin e ofertave;
- Transparencën ndaj pasqyrës së konsumatorëve;
- Çmimet personale (sipas rastit);
- Rishitjes së biletave të eventeve të blera në kabina;
- Sigurimi që pretendimet për uljen e çmimit të jene origjinale (të vërteta);
- **Fuqizimi i mbrojtjes së konsumatorit** – Direktiva gjithashtu propozon masa për t'u përmirësuar:
 - Kompensimi për viktimat e praktikave të padrejta tregtare;
 - Trajtimi i cilësisë së dyfishtë të mallrave të konsumit;
 - Mbrojtje më e mirë kundër praktikave të padrejta në rastin e shitjeve ‘derë-më-derë’ (shitësve mobil pran shtëpive) dhe ekskursioneve komerciale.

Rezultat i kësaj iniciative, zyra e BE-së në Kosovë, rekomandon për ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit për të përfshirë Direktivën 2019/2161 (BE) për zbatimin dhe modernizimin më të mirë të rregullave të Bashkimit për mbrojtjen e konsumatorit. Përmes një raporti të dërguar nga projekti ‘FMG-MTI’, zyra e BE-s propozon një listë të ndryshimeve në Ligjin e Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorit për ta sjellë atë në përputhje me Direktivën 2019/2161 (BE) për zbatimin dhe modernizimin më të mirë të rregullave të Bashkimit për mbrojtjen e konsumatorit.

Ndryshimet e rekomanduara në Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit

Neni. LMK	Ndryshimet e rekomanduara	Neni EU/2161/ 2019
137	Shtohet: 1. kriteret e mëposhtme jo-shteruese dhe indikative merren parasysh për vendosjen e gjobave, kur është e përshtatshme: (a) natyra, graviteti, shkalla dhe kohëzgjatja e shkeljes; (b) çdo veprim i ndërmarrë nga shitësi ose furnizuesi për të zbutur ose korrigjuar dëmin e pësuar nga konsumatorët; (c) çdo shkelje të mëparshme nga shitësi ose furnizuesi; (d) përfitimet financiare të fituara ose humbjet e shmangura nga shitësi ose furnizuesi për shkak të shkeljes, nëse të dhënat përkatëse janë në dispozicion; (e) çdo faktor tjetër rëndues ose lehtësues i zbatueshëm për rrethanat e çështjes.	1.3

	Direktiva 2161/2019 ua imponon Shteteve Anëtare të BE-s detyrimin për të vendosur gjobën maksimale për të paktën 4% të qarkullimit së shitjes / 2 milion euro, në rastin e shkeljeve / shkaktimeve të dëmeve ndërkufitare (p.sh. kur shitësi shkel rregullat në të paktën 2 shtete anëtare). Këto dispozita duhet të shtohen gjatë rrugëtimit të Kosovës për anëtarësim në BE.	1.4, 1.5
33	Shtohet: 1. Çdo njoftim i uljes së çmimit duhet të tregojë çmimin paraprak të aplikuar nga tregtari për një periudhë të caktuar kohe para aplikimit të uljes së çmimit. Çmimi paraprak nënkupton çmimin më të ulët të aplikuar nga tregtari gjatë një periudhe kohore jo më të shkurtër se 30 ditë para aplikimit të uljes së çmimit, përveç mallrave që mund të përkeqësohen ose skadojnë shpejt.	2
3.1.4	Zëvendëso me 'Produkt' - çdo e mire, produkt ose shërbim duke përfshirë pasurinë e paluajtshme, shërbimin dixhital dhe përmbajtjen dixhitale, si dhe të drejtat dhe detyrimet';	3
3	Shtohet 1.65 Statusi – rëndësia relative e produkteve, siç prezantohen, organizohen ose komunikohen nga tregtari, pavarësisht nga mjetet teknologjike të përdorura për prezantimin, organizimin ose komunikimin e tillë.; 1.66 treg në internet - një shërbim që përdor softuer, përfshirë ueb-faqe në internet, ueb-faqe të përsëritshme ose një aplikacion, që përdoret nga ose për llogari të një tregtari që lejon konsumatorët të lidhin kontrata në distancë me tregtarë ose konsumatorë të tjerë. ';	3
8	Shtohet 1.11.a. Sigurimi i rezultateve të kërkimit në përgjigje të kërkim-shpjegimeve nga konsumatorët përmes internetit pa shpalosur reklamime apo pagesa posaçërisht për arritjen e një renditjeje më të lartë të produkteve brenda rezultateve të kërkimit.'; 1.24 a. Rishitja e biletave të ngjarjeve konsumatorëve nëse tregtari i ka fituar ato duke përdorur mjete të automatizuara për të anashkaluar çdo kufi të vendosur në numrin e biletave që një person mund të blejë ose ndonjë rregull tjetër që zbatohet për blerjen e biletave. b. përmes deklarimit që pasqyra e një produkti është ofruar nga konsumatorët që kanë përdorur ose blerë në të vërtetë produktin pa marrë hapa të arsyeshëm dhe proporcional për të verifikuar nëse ato vijnë nga konsumatorë të tillë. c. Angazhimi ose porositja e një personi tjetër juridik ose fizik për të ofruar pasqyrë të rreme si konsumatorë, ose paraqitje të rreme të vlerësimeve të konsumatorëve ose vërtetime sociale, me qëllim promovimin e produkteve. '	
9.3	Shtohet 3. Çdo promovim i mallit si identik me një mall të tregtuar në një vend tjetër të BE-së, përderisa ai mall ka përbërje ose karakteristika dukshëm	

	të ndryshme, përveç nëse justifikohet nga faktorë legjitimë dhe objektivë. ';	
10	Zëvendëso 10.4.4 me aranzhimet për pagesa, dorëzim dhe performancë, nëse ato largohen nga kërkesat e kujdesit profesional; ' Shtohet 10.4.6. për produktet e ofruara në tregjet on-line, pavarësisht nëse pala e tretë që ofron produktet është një tregtar apo jo, në bazë të deklaratës së asaj pale të tretë për ofruesin e tregut në internet. Shtohet 10.5 Kur u ofrohet konsumatorëve mundësia për të kërkuar për produktet e ofruara nga tregtarë të ndryshëm ose nga konsumatorët në bazë të një pyetjeje në formën e një fjale kyçe, fraze ose inputi tjetër, pavarësisht se ku/kur arrihen përfundimisht transaksionet, informacioni i përgjithshëm, i bërë i disponueshëm në një seksion specifik në faqen në internet që është drejtpërdrejt dhe lehtësisht i arritshëm nga faqja ku paraqiten rezultatet e hulumtimit, mbi parametrat kryesorë që përcaktojnë renditjen e produkteve të paraqitura tek konsumatori si rezultat i pyetjes së kërimit dhe rëndësisë relative të këtyre parametrave, në krahasim me parametrat e tjerë, do të konsiderohen si materiale. Ky paragraf nuk zbatohet për ofruesit e shërbimeve të kërimit në internet. Shtohet 10.6 Where a trader provides access to consumer reviews of products, information about whether and how the trader ensures that the published reviews originate from consumers who have actually used or purchased the product shall be regarded as material. Kur një tregtar ofron qasje konsumatorit pasqyrë në vlerësimet e produkteve, informacioni qysh dhe si tregtari siguron që vlerësimet e publikuara vijnë nga konsumatorët që kanë përdorur ose blerë në të vërtetë produktin do të konsiderohen si material.	
3	Shtohet Mallrat - (a) çdo send i luajtshëm dhe i prekshëm; uji, gazi dhe energjia elektrike duhet të konsiderohen si mallra brenda kuptimit të kësaj Direktive, kur ato janë vendosur për shitje në një vëllim të kufizuar ose një sasi të caktuar; (b) çdo send i luajtshëm dhe i prekshëm që përfshin ose është i ndërlidhur me përmbajtje dixhitale ose një shërbim dixhital në mënyrë të tillë që mungesa e asaj përmbajtje dixhitale ose shërbimi dixhital të parandalojë mallrat të kryejnë funksionet e tyre ('mallrat me elemente dixhitale'); Të dhënat personale - çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave'); një person fizik i identifikueshëm është ai që mund të identifikohet, drejtpërdrejt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një identifikuesi të tillë si një emër, një numri identifikimi, të dhënat e vendndodhjes, një identifikuesi në internet ose një ose më shumë faktorë specifik fizik,	4

	fiziologjik, identiteti, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror të atij personi fizik; Kontrata e shitjes - çdo kontratë sipas së cilës tregtari transferon ose merr përsipër të transferojë pronësinë e mallrave të konsumatori, përfshirë çdo kontratë që ka si objekt të saj edhe mallrat edhe shërbimet; 'Shërbim dixhital' do të thotë një shërbim dixhital siç përcaktohet në pikën (2) të nenit 2 të Direktivës (BE) 2019/770; Tregu në formë elektronike - një shërbim që përdor softuerin, duke përfshirë një faqe në internet, pjesërisht një faqe në internet ose një aplikacion, të operuar nga ose për llogari të një tregtari që lejon konsumatorët të lidhin kontrata në distancë me tregtarë ose konsumatorë të tjerë; Ofruesi i një tregu në formë elektronike - çdo tregtar i cili siguron një treg në internet për konsumatorët; Përputhshmëria - aftësia e përmbajtjes dixhitale ose shërbimit dixhital për të funksionuar me harduer ose softuer me të cilin përdoren normalisht përmbajtja dixhitale ose shërbimet dixhitale të të njëjtit lloj, pa nevojën e konvertimit të përmbajtjes dixhitale ose shërbimit dixhital; Funksionaliteti - aftësia e përmbajtjes dixhitale ose shërbimit dixhital për të kryer funksionet e tij duke pasur parasysh qëllimin e tij; Ndërveprimi - aftësia e përmbajtjes dixhitale ose shërbimit dixhital për të funksionuar me pajisje ose softuer të ndryshëm nga ato me të cilat përdoren zakonisht në relacion me përmbajtjen dixhitale ose shërbimet dixhitale të të njëjtit lloj; Zëvendëso 1.31 me Kontratë shërbimi - çdo kontratë përveç kontratës së shitjes sipas së cilës tregtari furnizon ose merr përsipër të furnizojë një shërbim, përfshirë një shërbim dixhital, të konsumatori	
37.1	Shtohet Ky ligj do të zbatohet gjithashtu kur tregtari furnizon ose merr përsipër të furnizojë përmbajtje dixhitale e cila nuk është furnizuar në një medium të prekshëm ose një shërbim dixhital për konsumatorin dhe konsumatori siguron ose merr përsipër të sigurojë të dhëna personale tregtarit, përveç kur të dhënat personale të siguruar nga konsumatori pricesohen ekskluzivisht nga tregtari për qëllimin e furnizimit me përmbajtje dixhitale e cila nuk është furnizuar në një medium të prekshëm ose shërbim dixhital në përputhje me këtë Direktivë ose për të lejuar që tregtari të veprojë në përputhje me kërkesat ligjore për të cilat tregtari është subjekt, dhe tregtari nuk i përpunon ato të dhëna për ndonjë qëllim tjetër	
37.2	Shtohet 2.13. për çdo mall që shitet me anë të ekzekutimit ose ndryshe nga autoriteti ligjor	
38	Zëvendëson 38.1.5. me përveç përkujtimit të ekzistencës së garancisë ligjore të konformitetit për mallrat, përmbajtjen dixhitale dhe shërbimet dixhitale, ekzistencën dhe kushtet e shërbimeve pas shitjes dhe garancitë tregtare, kur është e zbatueshme	

	Zëvendëson 38.1.7. me Aty ku është e zbatueshme, funksionaliteti, përfshirë masat e zbatueshme të mbrojtjes teknike, të mallrave me elemente dixhitale, përmbajtje dixhitale dhe shërbimeve dixhitale; Zëvendëson 38.1.8. me Aty ku është e zbatueshme, çdo përputhshmëri dhe ndërveprim i rëndësishëm i mallrave me elemente dixhitale, përmbajtje dixhitale dhe shërbime dixhitale për të cilat tregtari është i vetëdijshëm ose mund të pritët që të ketë qenë i vetëdijshëm.	
39	Zëvendëson 39.1.3. me Adresa gjeografike në të cilën është vendosur tregtari, si dhe numri i telefonit dhe adresa e postës elektronike të tregtarit; përveç kësaj, kur tregtari siguron mjete të tjera të komunikimit në internet që garantojnë që konsumatori mund të mbajë çdo korrespondencë me shkrim, duke përfshirë datën dhe kohën e një korrespondence të tillë, me tregtarin në një medium të qëndrueshëm, informacioni duhet të përfshijë gjithashtu detaje të atyre mjeteve të tjera; të gjitha ato mjete të komunikimit të siguruara nga tregtari do t'i mundësojnë konsumatorit që të kontaktojë tregtarin shpejt dhe të komunikojë me të në mënyrë efikase; kur është e zbatueshme, tregtari gjithashtu duhet të sigurojë adresën gjeografike dhe identitetin e tregtarit në emër të të cilit ai po vepron. '; Vendos 1.6 kur është e zbatueshme, që çmimi të jetë personalizuar në bazë të vendimmarrjes së automatizuar; Replace 39.1.13 with a reminder of the existence of a legal guarantee of conformity for goods, digital content and digital services; Zëvendëson 39.1.13 me përkujtim mbi ekzistencës garancisë ligjore të konformitetit për mallrat, përmbajtjen dixhitale dhe shërbimet dixhitale; Zëvendësoni 39.1.19 me aty ku është e zbatueshme, funksionaliteti, përfshirë masat e zbatueshme të mbrojtjes teknike, të mallrave me elemente dixhitale, përmbajtje dixhitale dhe shërbimeve dixhitale; Zëvendësoni 39.1.20 me aty ku është e zbatueshme, çdo përputhshmëri dhe ndërveprim i rëndësishëm i mallrave me elemente dixhitale, përmbajtje dixhitale dhe shërbime dixhitale për të cilat tregtari është i vetëdijshëm ose mund të pritët që të ketë qenë i vetëdijshëm.	
39a	Artikull i ri (ose 39A ose zhvendos të gjithë numërimin lart). Kërkesa shtesë specifike të informacionit për kontratat e lidhura në tregjet në internet 1. Para se një konsumator të lidhet me një kontratë në distancë, ose ndonjë ofertë përkatëse, në një treg në internet, ofruesi i një tregu në internet, pa paragjykuar nenin 7 deri në 12, do t'i sigurojë konsumatorit informacionin e mëposhtëm në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, si dhe të përshtatshme për mjetet e komunikimit në distancë: (a) informacion i përgjithshëm, i bërë i disponueshëm në një seksion specifik të faqes në internet që është drejtpërdrejt dhe lehtësisht i arritshëm nga faqja ku prezantohen ofertat, mbi parametrat kryesorë që	

	përcaktojnë renditjen e ofertave të paraqitura tek konsumatori si rezultat i pyetjes së kërkimit dhe rëndësia relative e atyre parametrave në krahasim me parametrat e tjerë; (b) nëse pala e tretë që ofron mallra, shërbime ose përmbajtje dixhitale është një tregtar apo jo, në bazë të deklaratës së asaj pale të tretë për ofruesin e tregut në internet; (c) kur pala e tretë që ofron mallra, shërbime ose përmbajtje dixhitale nuk është një tregtar, të drejtat e konsumatorit që burojnë nga ky ligj nuk zbatohen për kontratën; (d) kur është e zbatueshme, në mënyrën se si përcaktohen detyrimet në lidhje me kontratën ndërmjet palës së tretë që ofron mallrat, shërbimet ose përmbajtjen dixhitale dhe ofruesit të tregut në internet, një informacion i tillë është pa paragjykuar ndonjë përgjegjësi që ofruesi i tregut në internet ose tregtar - pale e tret ka në lidhje me kontratën sipas një ligji tjetër nacional apo të BE-s.	
40	Zëvendëson 40.3 me Kur një konsumator dëshiron kryerjen e shërbimeve, ose furnizimin me ujë, gaz ose energji elektrike, kur ato nuk janë vendosur për shitje në një vëllim të kufizuar ose sasi të caktuar, ose të ngrohjes qendrore të fillojnë gjatë periudhës së tërheqjes të parashikuar në nenin 42.2. dhe kontrata e përcakton detyrimin e konsumatorit për të paguar, tregtari do të kërkojë që konsumatori të bëjë shprehimisht një kërkesë të tillë në një medium të qëndrueshëm, njëherësh t'i kërkojë konsumatorit të vërtetojë se e ka pranuar që, pasi kontrata të jetë kryer plotësisht nga tregtari, konsumatori do të ketë më të drejtë tërheqjeje.'	
41	Zëvendëson 41.5 me Nëse kontrata është përdorur përmes një komunikimi në distancë që lejon hapësirë ose kohë të kufizuar për të shfaqur informacionin, tregtar duhet të sigurohet, mbi ose përmes atij mjeti të veçantë para lidhjes së kontratës, që të paktën të ofroj informacionin parakontraktual në lidhje me karakteristikat kryesore të mallrave ose të shërbimeve, identitetin e tregtarit, çmimin total, të drejtën e këshillimit, kohëzgjatjen e kontratave dhe, nëse kontrata është më kohë të papërcaktuar, kushtet për shkëputjen e kontratës, duke u referuar, respektivisht, në nën paragrafët 1.1.; 1.2. 1.5; 1.9. dhe 1.16. të Nenit 39 të këtij Ligji, përjashtuar formën e tërheqjes sikurse përcaktohet me rregullore të veçantë. Informacioni shtesë sipas Nenit 39 të këtij Ligji, duke përfshirë modelin e formularit për t'u tërhequr, duhet që të sigurohet nga tregtari për konsumatorin në një mënyrë të përshtatshme në përputhje me paragrafin 1 të këtij Neni.	
	Zëvendëson 41.9 me Kur një konsumator dëshiron realizimin e shërbimeve, ose furnizimi me ujë, gaz ose energji elektrike, kur ato nuk janë vendosur për shitje në një vëllim të kufizuar ose sasi të caktuar, ose të ngrohjes qendrore, të fillojnë gjatë periudhës së tërheqjes sikurse parashihet në Nenin 42, dhe kontrata e obligon konsumatorin nën një detyrim për të paguar, tregtari duhet të kërkojë që konsumatori të bëjë një kërkesë urgjente, njëherësh t'i kërkojë konsumatorit konfirmimin se e ka kuptuar që, pasi kontrata	

	të jetë kryer plotësisht nga tregtari, konsumatori nuk do të ketë më të drejtën e tërheqjes.	
42	Zëvendëson 42.1 me a. Përjashtuar dispozitat përjashtuese të parashikuara në Nenin 49 të këtij Ligji, konsumatori ka një periudhë prej katërmëdhjetë (14) ditësh për t'u tërhequr nga një kontratë në distancë ose jashtë objektit afarist, pa dhënë ndonjë arsye dhe pa u ngarkuar me ndonjë kosto shtesë përveç atyre të parashikuara në Nenin 46 dhe 47 të këtij Ligji. b. Kësaj periudhe i shtohen 30 ditë për kontratat e lidhura në kontekstin e vizitave të pakërkjuara nga një tregtar në vendbanimin e një konsumatori ose ekskursione të organizuara nga një tregtar me qëllim ose efekt të promovimit ose shitjes së produkteve të konsumatorët me qëllim të mbrojtjes së interesave legjitime të konsumatorëve krahas praktikave agresive, mashtruese ose të shitjes. Rregulla të tilla duhet të jenë proporcionale, jo diskriminuese dhe të justifikuara për shkak të mbrojtjes së konsumatorit.	
	Zëvendëson 42.2 paragrafin e parë me Pa paragjykuar dispozitat e nenit 43 të këtij ligji, periudha e tërheqjes nga paragrafi 1 i këtij neni skadon pas katërmëdhjetë (14) ditësh, ose në rastet në përputhje me paragrafin 1b të këtij neni, 30 ditë nga:	
43	Zëvendëson 43.2 me Nëse tregtari i ka siguruar konsumatorit informacionin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni brenda dymbëdhjetë (12) muajve nga dita sikurse e përcakton neni 42 i këtij ligji, afati i tërheqjes skadon katërmëdhjetë (14) ditë pas ditës mbi të cilën konsumatori merr atë informacion, në rastet e nenit 42.1b, 30 ditë pas ditës në të cilën konsumatori e merr atë informacion. '	
46	Shto Tregtari duhet të kufizohet në përdorimin e ndonjë përmbajtje, përveç të dhënave personale, të cilat janë ofruar ose krijuar nga konsumatori kur ai përdor përmbajtjen dixhitale ose shërbimin dixhital të furnizuar nga tregtari, përveç kur një përmbajtje e tillë: (a) nuk ka ndonjë dobi jashtë kontekstit të përmbajtjes dixhitale ose shërbimit dixhital të furnizuar nga tregtari; (b) lidhet vetëm me aktivitetin e konsumatorit kur përdor përmbajtjen dixhitale ose shërbimin dixhital të furnizuar nga tregtari; (c) është përmbledhur / përzier me të dhëna të tjera nga tregtari dhe nuk mund të ndahen ose nevojitet përpyetje jo proporcionale; ose (d) është krijuar së bashku nga konsumatori dhe të tjerë, dhe konsumatorët e kanë mundësinë të vazhdojnë të përdorin këtë përmbajtje. 6. Me përjashtim të situatave të përmendura në pikat (a), (b) ose (c) të paragrafit 5, me kërkesë të konsumatorit, tregtari do të vërë në dispozicion të konsumatorit çdo përmbajtje, përveç të dhënave personale, të cilat janë ofruar ose krijuar nga konsumatori përgjatë përdorimit të përmbajtjes dixhitale ose shërbimit dixhital të furnizuar nga tregtari. 7. Konsumatori ka të drejtë të tërheq përmbajtjen dixhitale pa u penguar nga tregtari, brenda një kohe të arsyeshme dhe në një format të përdorur zakonisht dhe mekanikisht të lexueshëm.	

	8. Në rast tërheqjeje nga kontrata, tregtari mund të parandalojë çdo përdorim të mëtejshëm të përmbajtjes dixhitale ose shërbimit dixhital nga konsumatori, në veçanti duke e bërë përmbajtjen dixhitale ose shërbimin dixhital të paarritshëm për konsumatorin ose duke e bërë jo të vlefshme llogarinë e konsumatorit, pa paragjykuar paragrafin 6. ';	
47	Shtohet 2a Në rast tërheqjeje nga kontrata, konsumatori do të përmbahet nga përdorimi i përmbajtjes dixhitale ose shërbimit dixhital dhe nga vënia e tij në dispozicion të palëve të treta Zëvendësohet 6.2.1 konsumatori nuk ka dhënë pëlqimin paraprak të për fillimin e performancës para përfundimit të periudhës 14-ditore ose 30-ditore të referuar në nenin 42';	
49	Zëvendësohet 49.1.1 me Kontratat e shërbimit pasi shërbimi është kryer plotësisht, por nëse kontrata e vë konsumatorin nën një detyrim për të paguar, vetëm nëse performanca ka filluar me pëlqimin paraprak të shprehur nga konsumatori dhe te berit me dije se ai do të humbasë të drejtën e tij të tërheqjes pasi kontrata të jetë përmbushur plotësisht nga tregtari; ' Zëvendësohet 49.1.13 me kontrata për furnizimin e përmbajtjes dixhitale e cila nuk është furnizuar në një medium të prekshëm nëse performanca ka filluar dhe, nëse kontrata e vë konsumatorin nën një detyrim për të paguar, kur: (i) konsumatori ka dhënë pëlqimin paraprak për të filluar me performancën përgjatë periudhës mbi të drejtën e tërheqjes; (ii) konsumatori ka siguruar konfirmimin se ai në këtë mënyrë humbet të drejtën e tij të tërheqjes; (iii) tregtari ka dhënë konfirmim në përputhje me nenin 7 (2) ose nenin 8 (7). ';	

IV. Evolucionin e rregullimit të tregtisë elektronike është qartë i dukshëm në rastin e Bashkimit Evropian, i cili ka miratuar një numër rregulloresh të reja që nga viti 2000, dhe gjithashtu po konsideron rregullore të reja. Në lidhje me këtë, për shembull, Komisioni ka propozuar rregulla të reja për kontratat digjitale, të cilat aktualisht janë duke u diskutuar nga Parlamenti dhe Këshilli. Për më tepër, BE ka miratuar rregulla të rishikuara të mbrojtjes së konsumatorit. Me këtë rast, duhet të theksohen gjithashtu zhvillimet e rëndësishme që kanë ndodhur në vitet e fundit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë, të cilat duhet të përfshihen në modernizimin e kornizës ligjore të Kosovës që rregullon tregtinë elektronike. Në kontekstin e zhvillimeve të reja në rregullimin e tregtisë elektronike në BE, dhe duke marrë parasysh zotimet dhe angazhimet e Kosovës në MSA për të harmonizuar legjislacionin e saj me *Acquis* të BE, e bën qartë evidente se zhvillimet legjislative në Kosovë janë absolutisht të nevojshme. Për këtë, duhet të ketë instrument ligjor që mbulon fusha të ndryshme që i përkasin një rregullimi efikas të tregtisë elektronike për rritjen e mirëqenies së konsumatorit, pa kompromentuar zhvillimin e tregtisë elektronike në vend. Mbrojtja e konsumatorit përmes 'blerjes së internetit' parashihet të trajtohet si kapitull i veçantë dhe/apo përmes udhëzimit administrativ të veçantë.

2) Masat administrative dhe dispozitave ndëshkuese

Ne bazë të raportit 'Zhvillimi i Legjislacionit si Bazë për Zbatimin Efikas' (Misioni nga 'FMG-BE - Mbikëqyrja e Tregut - Gusht 2020), fokusi ishte në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të Kosovës me *acquis* e konsumatorit. Për këtë qëllim, brenda misionit është ndërmarrë një analizë fillestare e legjislacionit ekzistues të Kosovës dhe janë dhënë vëzhgime paraprake në lidhje me aktivitetet e ardhshme në këtë fushë. Rezultat i misionit u hartua dokumenti i quajtur "Vlerësimi i masave administrative dhe dispozitave penale të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit".

Objektivi i detyrës ishte i dyfishtë; së pari për të analizuar legjislacionin ekzistues të Kosovës në fushën e mbrojtjes së konsumatorit me qëllim të krijimit të strukturës dhe përgjegjësi në fushën e mbikëqyrjes së tregut të mbrojtjes së konsumatorit, si dhe për të siguruar një vlerësim paraprak të dispozitave aktuale për mbikëqyrjen e tregut në fushën mbrojtjes së konsumatorit. Kështu, misioni u realizua në formën e analizës së legjislacionit përkatës për Mbrojtjen e Konsumatorit, ku si rezultat, u hartua dokumenti me emrin "Vlerësimi i masave administrative dhe dispozitave penale të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit".

Analiza e legjislacionit përkatës, me këtë rast ka identifikuar një nivel të caktuar paqartësie në lidhje me shpërndarjen e kompetencave në mbikëqyrjen e tregut në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Kështu fillimisht, neni 9 i Ligjit për Inspektime sugjeron që në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, Inspektorati i Tregut është ekskluzivisht kompetent për mbikëqyrjen e tregut. Ky pozicion duket se kundërshton nenin 135/2 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit, i cili parashikon që mbikëqyrja inspektuese e këtij ligji kryhet nga organet e administratës shtetërore, inspektoratet kompetente, personat e pavarur juridikë të autorizuar për të kryer mbikëqyrjen e inspektimit dhe autoritetet lokale përmes inspektorëve lokalë, brenda kompetenca e qeverisjes vendore.

Parmës një analize paraprake, së pari, është konstatuar se, në rastet kur e njëjta fushë e rregullimit rregullohet në dy burime të ndryshme në dy mënyra të ndryshme, ndikon negativisht në sigurinë ligjore dhe efikasitetin në sigurimin e mbrojtjes ligjore, dhe për këtë arsye duhet të shmangen. Së dyti, megjithëse Shtetet Anëtare të BE-së (si dhe vendet që aspirojnë anëtarësimin në BE) janë përgjithësisht të lira të përcaktojnë përgjegjësitë në fushën e mbikëqyrjes së tregut siç e gjykojnë të arsyeshme, duke i caktuar kompetencë ekskluzive një organi në një zonë mjaft të gjerë si mbrojtja e konsumatorit, çfarë duket se është rasti në Kosovë sipas Neni 9 të Ligjit për Inspektime, mund të ngrejë shqetësime për efikasitetin. Duke pasur parasysh se legjislacioni i BE-së për mbrojtjen e konsumatorit përfshin një zonë shumë të gjerë, që rregullon sektorë shumë të ndryshëm të ekonomisë dhe që ndërlidhen me fusha shumë të ndryshme ligjore, vihet në pikëpyetje nëse një organ i vetëm (administrativ) është i pajisur në mënyrë adekuate, për sa i përket personelit, burimeve dhe ekspertizës, për të kryer në mënyrë efikase mbikëqyrjen e tregut në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Së treti, ndryshe nga neni 9 i Ligjit për Inspektime (Inspektorati i Tregut), neni 135/2 i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit cakton kompetencë në fushën e mbrojtjes së konsumatorit organeve të ndryshme, pa specifikuar kush është përgjegjës për çfarë. Kjo mund të shkaktojë raste të shpeshta të konfliktit të kompetencave, pozitive dhe negative, të cilat mund të ndikojnë negativisht në efikasitetin e mbikëqyrjes së tregut në këtë fushë. Për më tepër, duke pasur parasysh që përcaktimi i tillë i paqartë i kompetencave mund t'i pengojë konsumatorët nga përdorimi i mekanizmave të mbrojtjes së konsumatorit, situata ekzistuese mund të ndikojë negativisht në nivelin e mbrojtjes së konsumatorit edhe në Kosovë.

Për arsyet e mësipërme, edhe për faktin se Udhëzimi Administrativ për Shqyrtimin e Ankesave nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit, në një masë të konsiderueshme e ka definuar këtë qeshje, është e rekomandueshme rishikimi në lidhje me kompetencat në mbikëqyrjen e tregut në lidhje me mbrojtjen e konsumatorit me qëllim të përcaktimit të kompetencave në këtë fushë në një mënyrë më edhe më precize dhe më të qartë.

Analiza paraprake gjithashtu identifikon se një numër i dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit nuk mbështeten nga masa adekuate administrative dhe / ose dispozita penale (të renditura më poshtë). Prandaj është e rekomandueshme që të konsiderohet gjithashtu ndryshimi i Ligjit ekzistues për Mbrojtjen e Konsumatorit me qëllim të mbështetjes së dispozitave të veçanta të këtij Ligji me masa administrative adekuate dhe/ose dispozita penale, për të arritur kështu një efikasitet të plotë të kornizës legjislative të mbikëqyrjes së tregut në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Brenda këtyre konteksteve, vlerësimi i masave administrative dhe dispozitave ndëshkuese në kuadër të Ligjit aktual për Mbrojtjen e Konsumatorit ka rezultuar në mangësi sikurse:

1. Mangësitë në masa adekuate administrative:
 - Praktika të padrejta tregtare (nenet 6-12);
 - Ndalimi i shpërndarjes së materialit promovues (neni 14);
 - Mbrojtja speciale e të miturve (neni 15);
 - Sigurimi i shërbimeve publike (neni 20);
 - Lidhja me rrjetin e shpërndarjes (neni 21);
 - Përfundimi i shërbimeve (neni 22);
 - Sigurimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve (neni 24);
 - Faturimi i shërbimeve publike (neni 25);
 - Çmimi i shërbimeve (neni 27);
 - Shitja e mallrave në kioska ose objekte të ngjashme (neni 28);
 - Çmimet në reklamim (neni 31);
 - Ankandet, uljet dhe zbritjet sezonale (nenet 32-36);
 - E drejta e tërheqjes nga kontrata (neni 42);
 - Mosveprimi i informacionit për të drejtën e tërheqjes nga kontrata (neni 43);
 - Komunikimi me telefon, pagesa shtesë, kthimi i ndryshimit (nenet 54-56);
 - Premtimi i dhënies, pagesa paraprake, ri-mbursimi i pagesave të kartave të kreditit (nenet 58-60);
 - Informacion për konsumatorin para lidhjes së kontratës në distancë, kërkesa shtesë për informacion, komunikimin e termave dhe kushteve kontraktuale dhe të informacionit paraprak, e drejta e tërheqjes, pagesa e shërbimeve para tërheqjes, të drejtat e konsumatorit në rast të keqpërdorimit të kartës së pagesës, shërbime të pakërkua komunikime të pakërkua (nenet 62-69);
 - konformiteti i mallrave (nenet 77-81);
 - kreditë e konsumatorit (nenet 85-87, 89-95, 97, 99, 100, 102);
 - ndarja në kohë, produktet afatgjata të pushimeve, kontratat e rishitjes dhe shkëmbimit (nenet 103-109, 111-114).

Mangësitë në dispozita adekuate ndëshkuese:

- Praktika të padrejta tregtare (nenet 6-12);
- Sigurimi i shërbimeve publike (neni 20, përveç nenit 20/3);
- Lidhja me rrjetin e shpërndarjes (neni 21);
- Përfundimi i shërbimeve (neni 22);
- Ruajtja e cilësisë së shërbimit (neni 23);
- Sigurimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve (neni 24);

- Faturimi i shërbimeve publike (neni 25);
- Çmimi i shërbimeve (neni 27, përveç paragrafit 3);
- Çmimet në reklamim (neni 31);
- Ulje ose lejime (neni 33);
- E drejta e tërheqjes nga kontrata (neni 42);
- Mosveprimi i informacionit për të drejtën e tërheqjes nga kontrata (neni 43);
- Komunikimi me telefon (neni 54);
- Rimbursimi i pagesave të kartës së kreditit (neni 60);
- Kërkesa shtesë për informacion, komunikimi i termave dhe kushteve kontraktuale dhe i informacionit paraprak, e drejta e tërheqjes, pagesa e shërbimeve para tërheqjes, të drejtat e konsumatorit në rast të keqpërdorimit të kartës së pagesës, shërbime të pakërkuara, komunikime të pakërkuara (nenet 63-69);
- Kushtet e padrejta të kontratës (neni 71);
- Konformiteti i mallrave (nenet 78-81);
- Kreditë e konsumatorit (nenet 91, 95-97, 100);
- Ndarja në kohë, produktet afatgjata të pushimeve, kontratat e rishitjes dhe shkëmbimit (nenet 106-109, 111-114).

Brenda këtyre konteksteve, Raporti vlerësimi i masave administrative dhe dispozitave ndëshkuese në kuadër të Ligjit aktual për Mbrojtjen e Konsumatorit, rekomandon që:

Neni 136 duhet të ndryshohet në mënyrë që të lexohet:

Neni 136 Masat administrative

1. Përveç masave administrative të përcaktuara me Ligjin për Mbikëqyrjen e Inspektimit, inspektori kompetent duhet të udhëzojë tregtarin të heqë parregullsitë e identifikuara dhe të specifikojë një periudhë brenda së cilës duhet të hiqen parregullsitë e identifikuara, nëse gjatë inspektimit është vërtetuar se:

- 1.1. tregtari nuk ka arritur të përmbushë kërkesat e përshkruara në nenin 13 të këtij ligji;
- 1.2. tregtari nuk ka arritur të respektojë ndalimin e shpërndarjes së materialit promovues të parashikuar në nenin 14 të këtij ligji;
- 1.3. tregtari nuk ka arritur të përmbushë kërkesat për mbrojtje të veçantë të të miturve të parashikuara në nenin 15 të këtij ligji;
- 1.4. mallrat ose shërbimet nuk janë të etiketuara siç përcaktohet neni 16 i këtij ligji;
- 1.5. tregtari ka dështuar të sigurojë materialin e duhur të paketimit ose ka llogaritur peshën dhe madhësinë në mënyrë joadekuate të nenit 17 të këtij ligji;
- 1.6. tregtari nuk ka arritur të dorëzojë deklaratën e mallrave me specifikimet e saj siç parashikohet në nenin 18 të këtij ligji;
- 1.7. tregtari nuk ka arritur të vendosë në etiketë përmbajtjen e mallrave ose paketimin e mallrave, siç përcaktohet në nenin 19 të këtij ligji;
- 1.8. Njoftimi është vendosur në mallra në atë mënyrë që dëmton mallrat në paragrafin 5. neni 19 i këtij ligji;
- 1.9. tregtari nuk ka arritur të ofrojë shërbime publike siç parashikohet në nenin 20 të këtij ligji;
- 1.10. tregtari ka dështuar t'i sigurojë një konsumatori një lidhje në rrjetin e shpërndarjes siç parashikohet në nenin 21 të këtij ligji;
- 1.11. tregtari ndërpreu ofrimin e shërbimeve në kundërshtim me nenin 22 të këtij ligji;
- 1.12. cilësia e shërbimit të ofruar për interesin publik nuk është në përputhje me nenin 23 të këtij ligji;

- 1.13. tregtari nuk ka arritur të ruajë cilësinë e shërbimeve publike në kundërshtim me nenin 24 të këtij ligji; 1.14. tregtari nuk ka arritur të faturojë shërbimet publike siç parashikohet në nenin 25 të këtij ligji;
- 1.15. çmimi nuk paraqitet ose nuk është i disponueshëm në mënyrën dhe në kushtet e përcaktuara në nenin 26 të këtij ligji;
- 1.16. tregtari nuk ka arritur të shfaq çmimet e shërbimeve siç parashikohet në nenin 27 të këtij ligji;
- 1.17. tregtari nuk ka arritur të shfaq çmimet e mallrave të shitura në kioska ose objekte të ngjashme siç parashikohet në nenin 28 të këtij ligji;
- 1.18. lista e çmimeve për njësi nuk është vendosur në stacionin e karburantit siç përcaktohet në nenin 29 të këtij ligji;
- 1.20. tregtari nuk ka arritur të vendosë listën e çmimeve në hyrjen e parkimit siç përcaktohet në nenin 30 të këtij ligji;
- 1.21. nëse çmimi me pakicë i mallrave ose shërbimeve dhe çmimet për njësi të mallrave të botuara në reklama, nuk janë të njëjta me ato të përcaktuara në nenin 31 të këtij ligji;
- 1.22. tregtari nuk ka arritur të përmbushë kërkesat e përcaktuara për rastin e ankandeve, uljeve dhe zbritjeve sezonale siç parashikohet në nenet 32-36 të këtij ligji; 1.23. tregtari nuk ka arritur të informojë konsumatorin në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në lidhje me kontratat përveç kontratave në distancë dhe jashtë ndërtesave, në mënyrën dhe në kushtet e përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji;
- 1.24. tregtari nuk ka arritur të informojë konsumatorin në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në lidhje me distancën dhe kontratat jashtë lokaleve, në mënyrën dhe në kushtet e përcaktuara në nenin 39 të këtij ligji;
- 1.25. tregtari i ka mohuar konsumatorit të drejtën e saj për tërheqje nga një kontratë siç parashikohet në nenin 42 të këtij ligji;
- 1.26. tregtari ka hequr informacionin mbi të drejtën e konsumatorit për tërheqjen nga një kontratë e parashikuar në nenin 43 të këtij ligji;
- 1.27. tregtari dështoi të përmbushë detyrimet në rast të tërheqjes së konsumatorit nga një kontratë siç parashikohet në nenin 46 të këtij ligji; 1.28. tregtari nuk i ka siguruar konsumatorit produktin në mënyrën dhe në kushtet e përcaktuara në nenin 51 të këtij ligji;
- 1.29. tregtari nuk ka arritur të veprojë në mënyrën e përcaktuar me ligj, në lidhje me faturimin / tarifën e ndaluar të përcaktuara në nenin 52 të këtij ligji;
- 1.30. tregtari ka ngarkuar konsumatorin për përdorimin e një linje telefonike të operuar nga tregtari mbi normën bazë, në kundërshtim me nenin 54 të këtij ligji;
- 1.31. tregtari ka ngarkuar konsumatorin me pagesa shtesë në kundërshtim me nenin 55 të këtij ligji;
- 1.32. tregtari nuk ka arritur t'ia kthejë konsumatorit ndryshimin ose ka refuzuar të pranojë monedhat e vogla në kundërshtim me nenin 56 të këtij ligji;
- 1.33. tregtari ka dështuar të lëshojë një faturë për produktin e blerë, ose ka dështuar të lëshojë një faturë në mënyrën dhe përmbajtjen e përcaktuar në përputhje me nenin 57 të këtij ligji;
- 1.34. tregtari nuk i ka dorëzuar konsumatorit një çmim ose një çmim siç parashikohet në nenin 58 të këtij ligji;
- 1.35. tregtari nuk ka përmbushur detyrimin ose për të paguar interesin për parapagimin siç parashikohet në nenin 59 të këtij ligji;
- 1.36. tregtari nuk ka arritur të informojë një konsumator para lidhjes së një kontrate në distancë siç parashikohet në nenin 62 të këtij ligji;
- 1.37. tregtari ka dështuar t'i sigurojë konsumatorit informacione shtesë siç parashikohet në nenin 63 të këtij ligji;

- 1.38. tregtari nuk ka arritur t'i komunikojë konsumatorit termat dhe kushtet dhe informacionin paraprak siç parashikohet në nenin 64 të këtij ligji;
- 1.39. tregtari i ka mohuar konsumatorit të drejtën e tërheqjes nga kontrata e lidhur në distancë të parashikuar në nenin 65 të këtij ligji;
- 1.40. tregtari ka kërkuar nga një konsumator që të bëjë pagesa më shumë se sa parashikohet në nenin 66 të këtij ligji;
- 1.41. tregtari dështoi t'i kthehet një konsumatori ose të kompensojë konsumatorin për çdo shumë që konsumatori u akuzua për keqpërdorimin e kartës së saj të kreditit, siç parashikohet në nenin 67 të këtij ligji;
- 1.42. tregtari i ka siguruar një konsumatori një shërbim në distancë pa kërkesën e një konsumatori paraprak, në kundërshtim me nenin 68 të këtij ligji;
- 1.43. tregtari ka përdorur komunikime të pakërkua, në kundërshtim me nenin 69 të këtij ligji;
- 1.44 kushtet e kontratës së tregtarit nuk janë hartuar në gjuhë të thjeshtë, të kuptueshme, në kundërshtim me nenin 74 të këtij ligji;
- 1.45. tregtari nuk ka dorëzuar mallra që janë në përputhje me kontratën e shitjes, në kundërshtim me nenin 77 të këtij ligji;
- 1.46. tregtari i ka mohuar konsumatorit të drejtat e saj në rast të moskonformitetit të mallrave të dorëzuara me një kontratë shitje, në kundërshtim me nenin 78 të këtij ligji;
- 1.47. tregtari nuk ka respektuar garancinë e lëshuar në përputhje me nenin 81 të këtij ligji;
- 1.48. tregtari nuk ka arritur të përfshijë informacione standarde në reklama siç parashikohet në nenin 85 të këtij ligji;
- 1.49. tregtari ka dështuar t'i sigurojë një konsumatori informacione parakontraktore siç parashikohet në nenet 86 dhe 87 të këtij ligji;
- 1.50. tregtari nuk ka arritur të vlerësojë aftësinë për kredi të një konsumatori siç parashikohet në nenin 88 të këtij ligji;
- 1.51 tregtari nuk ka arritur të informojë një konsumator për rezultatet e konsultimit të Regjistrit të Kredive të Kosovës siç parashikohet në nenin 90 të këtij ligji;
- 1.52 tregtari nuk ka arritur të përfshijë informacionin e nevojshëm në një marrëveshje kredie siç parashikohet në nenin 91 të këtij ligji;
- 1.53 tregtari nuk ka arritur të informojë një konsumator për ndryshimin e normës së huamarrjes siç parashikohet në nenin 92 të këtij ligji;
- 1.54 tregtari nuk ka arritur të përmbushë detyrimet në lidhje me një marrëveshje kredie në formën e një lehtësimi të mbitërheqjes siç parashikohet në nenin 93 të këtij ligji;
- 1.55 tregtari i ka mohuar konsumatorit të drejtën për të kryer përfundimin e një kredie të hapur siç parashikohet në nenin 94 të këtij ligji;
- 1.56 tregtari i ka mohuar konsumatorit të drejtën e tërheqjes nga një marrëveshje kredie siç parashikohet në nenin 95 të këtij ligji;
- 1.57 tregtari i ka mohuar konsumatorit të drejtën e ripagimit të parakohshëm të një kredie siç parashikohet në nenin 97, paragrafi 1 i këtij ligji;
- 1.58. tregtari ka ngarkuar një konsumator me një kompensim për ripagimin e parakohshëm të llogaritur në kundërshtim me nenin 97, paragrafët 2-3 të këtij ligji;
- 1.59 tregtari ka ngarkuar një kompensim të konsumatorit për ripagimin e parakohshëm në kundërshtim me nenin 97, paragrafi 4 i këtij ligji;
- 1.60. marrëveshja e kredisë që lejon një tejkalim nuk përmban informacione siç parashikohet në nenin 99 të këtij ligji;
- 1.61. tregtari nuk ka arritur të llogarisë përqindjen vjetore të tarifës në përputhje me nenin 100 të këtij ligji;

- 1.62. tregtari nuk ka arritur të përmbushë detyrimet e informacionit siç parashikohet në nenin 103 të këtij ligji;
- 1.63. tregtari ka dështuar t'i sigurojë një konsumatori informacione parakontraktuese në lidhje me shpërndarjen në kohë, produktin për pushime afatgjata, rishitjen dhe kontratat e këmbimit siç parashikohet në nenin 104 të këtij ligji;
- 1.64. tregtari nuk ka arritur t'i komunikojë një konsumatori ndryshimet në marrëveshje siç parashikohet në nenin 105 të këtij ligji;
- 1.65. tregtari nuk ka arritur të përfshijë në kontratë informacione shtesë siç parashikohet në nenin 106 të këtij ligji;
- 1.66. tregtari nuk ka arritur të përmbushë kërkesat e formës dhe gjuhës në lidhje me ndarjen në kohë, produktet afatgjata të pushimeve, kontratat e rishitjes dhe shkëmbimit siç parashikohet në nenin 107 të këtij ligji;
- 1.67. tregtari ka dështuar të informojë një konsumator për të drejtën e saj për t'u tërhequr nga kontrata për produkte me kohë, produkte pushimesh afatgjata, rishitje dhe shkëmbim siç parashikohet në nenin 108 të këtij ligji;
- 1.68. tregtari i ka mohuar konsumatorit të drejtën e tërheqjes nga ndarja me kohë, produkti për pushime afatgjata, rishitjen dhe kontratat e këmbimit siç parashikohet në nenin 109 të këtij ligji;
- 1.69 tregtari ka kërkuar nga një paradhënie e konsumatorit, sigurimin e garancisë, rezervimin e parave në llogari, njohjen e qartë të borxhit ose ndonjë konsideratë tjetër para përfundimit të periudhës së tërheqjes në lidhje me ndarjen e kohës, produktin afatgjatë të pushimeve, kontratat e rishitjes dhe shkëmbimit, në kundërshtim të nenit 112 të këtij ligji,
- 1.70. tregtari ka kërkuar që pagesa të bëhet në kundërshtim me atë që parashikohet në nenin 113 të këtij ligji;
- 1.71. tregtari ka kërkuar që pagesa të bëhet në kundërshtim me atë që parashikohet në nenin 114, paragrafi 2 i këtij ligji;
- 1.72. tregtari nuk arriti ta mbajë dëshmi të ankesave të paraqitura nga konsumatorët, neni 115, paragrafi 6. i këtij ligji.
2. Inspektori kompetent do të lëshojë një vendim për të ndaluar përkohësisht tregtarin të shesë mallra ose të ofrojë shërbime derisa të mos eliminohen parregullsitë kur tregtari nuk ka arritur të respektojë vendimin e përmendur në paragrafin 1. të këtij neni.
3. Inspektori kompetent mund të nxjerrë një vendim për të ndaluar tregtarin të përdorë praktikën e padrejta tregtare, siç parashikohet në dispozitat e neneve 6-12 të këtij ligji dhe një vendim për të ndaluar përkohësisht tregtarin të përdorë kushtet e padrejta të kontratës sikurse parashihi në dispozitat e neneve 71, 72 dhe 73 të këtij ligji.
4. Ankesa kundër vendimeve të përmendura në paragrafët 1. deri 4. të këtij neni nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Nenet 137-139 duhet të ndryshohen për të përfshirë shkeljet e mëposhtme:

- përdor praktika të padrejta tregtare në kundërshtim me nenet 6-12;
- ofron shërbime publike në kundërshtim me nenet, 20, paragrafët 1-2;
- nuk i siguron konsumatorit lidhje me rrjetin e shpërndarjes në përputhje me nenin 21;
- përfundon ofrimin e shërbimeve në kundërshtim me nenin 22;
- dështon të ruajë cilësinë e shërbimit në kundërshtim me nenin 23;
- dështon t'i sigurojë një konsumatori qasjen dhe cilësinë e shërbimeve publike në përputhje me nenin 24;
- faturat e shërbimeve publike në kundërshtim me nenin 25;
- nuk tregon çmimin e shërbimeve në përputhje me nenin 27, paragrafët 1-2;

- nuk vë në dukje llojin dhe fushën e shërbimeve siç parashikohet në nenin 27, paragrafi 3;
- përdor çmime të ndryshme nga reklamimi në kundërshtim me nenin 31;
- zbritja me përqindjen më të lartë të shitjes ka të bëjë me më pak se një të pestën e të gjitha mallrave të ofruara për shitje në kundërshtim me nenin 33, paragrafi 1;
- mallrat e shitura me zbritje nuk janë shënuar qartë në kundërshtim me nenin 33, paragrafi 2;
- çmimet e zbritura nuk vendosen nën ose mbi çmimin paraprak në kundërshtim me nenin 33, paragrafi 2;
- i mohon një konsumatori të drejtën e tërheqjes nga kontrata në përputhje me nenin 42;
- harron të informojë një konsumator për të drejtën e saj të tërheqjes nga një kontratë në kundërshtim me nenin 43;
- ngarkon një konsumator me më shumë se një normë bazë për përdorimin e një linje telefonike të operuar nga tregtari në kundërshtim me nenin 54;
- dështon të sigurojë një konsumator me kërkesa shtesë për informacion, në kundërshtim me nenin 63;
- nuk i komunikon një konsumatori termat dhe kushtet kontraktuale dhe informacionin paraprak në kundërshtim me nenin 64;
- i mohon një konsumatori të drejtën e tërheqjes nga një kontratë në distancë në lidhje me shërbimet financiare në kundërshtim me nenin 65;
- kërkon çdo pagesë nga një konsumator para skadimit të periudhës së tërheqjes, duke tejkaluar atë që parashikohet në nenin 66;
- nuk arrin të kompensojë një konsumator ose të kthejë shumën e shpenzuar në rast të keqpërdorimit të kartës së kreditit të konsumatorit në kundërshtim me nenin 67;
- siguron shërbime të pakërkuara për konsumatorët në kundërshtim me nenin 68;
- angazhohet në komunikime të pakërkuara në kundërshtim me nenin 69;
- përdor kushte të padrejta të kontratës në kundërshtim me nenin 71;
- nuk i sjell mallrat në përputhje me kontratën siç parashikohet në nenin 78;
- nuk respekton garancinë e lëshuar në kundërshtim me nenin 82, paragrafi 1;
- garancia e lëshuar nuk përmban informacione siç parashikohet në nenin 81, paragrafi 2;
- garancia nuk vihet në dispozicion, me kërkesë të një konsumatori, me shkrim ose një medium tjetër të qëndrueshëm në dispozicion dhe i arritshëm për konsumatorin në kundërshtim me nenin 81, paragrafi 3;
- nuk përfshin në një marrëveshje kredie informacionin siç parashikohet në nenin 91;
- i mohon të drejtën një konsumatori të tërhiqet nga një marrëveshje kredie në kundërshtim me nenin 95;
- nuk lejon që një konsumator të kryejë ulje të çmimit në koston totale të kredisë në rastin e ripagimit të parakohshëm në përputhje me nenin 97;
- nuk llogarit përqindjen vjetore të përqindjes siç parashikohet në nenin 100;
- dështon t'i sigurojë një konsumatori informacion shtesë në lidhje me ndarjen në kohë, produktet afatgjata të pushimeve, kontratat e rishitjes dhe shkëmbimit siç parashikohet në nenin 106;
- dështon të hartojë ndarjen në kohë, produktet afatgjata të pushimeve, kontratat e rishitjes dhe shkëmbimit në formë dhe gjuhë siç parashikohet në nenin 107;
- dështon t'i sigurojë një konsumatori informacionin për të drejtën e tërheqjes siç parashikohet në nenin 108;
- tarifën, në rast tërheqjeje nga koha, produktet e pushimeve afatgjata, kontratat e rishitjes dhe shkëmbimit, një konsumator me kosto ose ndonjë vlerë që korrespondon me shërbimin që mund të jetë kryer para tërheqjes në kundërshtim me nenin 111;

- kërkon një parapagim të konsumatorit për sigurimin e garancive, rezervimin e parave në llogari, njohjen e qartë të borxhit ose ndonjë konsideratë tjetër në lidhje me ndarjen në kohë, produktet e pushimeve afatgjata, rishitjet dhe kontratat e shkëmbimit para se të skadojë periudha e tërheqjes, në kundërshtim me Neni 112;
- kërkon që një konsumator në rastin e pagesës së produkteve për pushime afatgjata të bëhet në një formë tjetër përveç një skeme pagese të shkelur në kundërshtim me nenin 113, paragrafi 1;
- dështon të dërgojë një kërkesë me shkrim për pagesë në letër ose një medium tjetër të qëndrueshëm të paktën katërmëdhjetë ditë kalendarike përpara çdo date të caktuar, në kundërshtim me nenin 113, paragrafi 1;
- ngarkon shpenzimet e një konsumatori për përfundimin e çdo kontrate ndihmëse të ndarjes në kohë, produkteve të pushimeve afatgjata, rishitjeve dhe kontratave të këmbimit në kundërshtim me nenin 114.

3) Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorit

Puna e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorëve është publike dhe ndër tjera, është e përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve, ku gjithashtu potencohet se ai:

- Paraqet organ këshillues lidhur me politikat për mbrojtjen e konsumatorit;
- Posedon Sekretarinë që kryen punët teknike për Këshillin;
- Funksionon në bazë të Rregullores së punës, të cilën e harton vetë Këshilli;
- Harton Programin për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe i raporton ministrit të MTI-së mbi zbatimin e Programit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, mbështet ndryshimet në legjislacion dhe rregulloret ekzistuese;
- Merr pjesë në krijimin e politikës për mbrojtjen e konsumatorëve dhe i raporton Qeverisë së Kosovës për rastet e shkeljeve kolektive të të drejtave të konsumatorëve;
- Dorëzon raportin vjetor Qeverisë Kosovës përmes ministrit të MTI-së.

Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të ministrit të MTI-së, emëron anëtarët e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit. Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorëve, përmes Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, i dorëzon raportin vjetor Qeverisë së Kosovës. Gjithashtu, me propozim të Ministrit/es, Qeveria miraton Programin për Mbrojtjen e Konsumatorëve. Përmes plotësimit ndryshimit të Ligjit, Puna e Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorit parashihet të rregullohet përmes Udhëzimit Administrativ.

Kapitulli 3: Opsionet

Nga grupi punues janë trajtuar gjithsej tri opsione për adresimin e problemit të identifikuar më lartë dhe arritjen e objektivave. Këto opsione janë: 1) opsioni asnjë ndryshim; 2) opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore; 3) opsioni që parasheh ndryshime ligjore.

Krahasimi me vendet tjera

Grupi punues gjatë përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti, ka marr parasysh përvojat e Bashkësisë Evropiane, për të krahasuar çështje të identifikuara në Kapitujt e mësipërm dhe që janë konsideruar të rëndësishme si model (të paktën pjesërisht). Ky entitet është zgjedhur sepse konsiderohet një nga rajonet ku më shumë praktikohet Mbrojtja e Konsumatorit, dhe se deri në shekullin e XXI-te, nuk ka pasur ndonjë zhvillim të qëndrueshëm në rajonin me të cilin përkon R. e Kosovës.

Modeli i BE-s

Aktualisht ekziston një qasje e larmishme ndaj mbrojtjes së konsumatorit në BE, me lloje/modele të ndryshme në operim në tregje të ndryshme. Mbrojtja e Konsumatorit është e detyrueshme në sektorë të caktuar ku ka një potencial të lartë për ta dëmtuar konsumatorin. Në sektorë të tjerë, veprojnë skema vullnetare nga ana e bizneseve të cilat kanë zgjedhur të bashkohen, dhe këto shpesh ndërlidhen me shoqatat tregtare (p.sh. agjentët e telekomunikacionit dhe pasurive të patundshme).

Shpenzimet e konsumit të familjeve në BE aktualisht zënë 57% të Prodhimit të Brendshëm Bruto. Prandaj, një treg i vetëm që u shërben mirë konsumatorëve është një element i rëndësishëm për stimulimin e rritjes ekonomike të Evropës. Rezoluta e Këshillit të 14 Prillit 1975 mbi një program paraprak për Komunitetin Ekonomik Evropian për një politikë të mbrojtjes së konsumatorit dhe informacionit përbënte inaugurimi zyrtar i politikës së mbrojtjes së konsumatorit në nivelin e BE-së. Me kalimin e kohës, politika e konsumatorit është bërë një nga politikat më transversale të BE-së, që mbulon sigurinë e produktit, tregun dixhital, shërbimet financiare, sigurinë dhe etiketimin e ushqimit, energjinë, udhëtimet dhe transportin. Në vitet e fundit, mbrojtja e konsumatorit është ri-pozicionuar nga harmonizimi teknik i standardeve, tek njohja e mbrojtjes së konsumatorit si pjesë e përpjekjes për të krijuar një 'Evropë për qytetarë'.

Programi i veprimit të BE-së në fushën e politikës së konsumatorit mbështetet në dy masa: Agjendën Evropiane të Konsumatorit, e cila konsiderohet si strategji e re për konsumatorin e BE-së në përputhje me strategjinë e rritjes dhe zhvillimin e BE, si dhe programi mbi konsumatorin - korniza financiare që plotëson strategjinë. Për më shumë, agjenda e konsumatorit përmban katër objektiva kryesor: përmirësimi i sigurisë së konsumatorit; ngritja e vetëdijesimit; zbatimi, apo rritja e zbatimit dhe siguri i qasjes alternative; si dhe harmonizimin e të drejtave dhe politikave kryesore ndaj sfidave ekonomike dhe shoqërore. Çështja e ndryshimit të mundshëm dhe të harmonizimit në nivel të BE-s ka rezultuar me Direktivat e përbashkëta. Në këtë kontekst, përderisa ka pasur histori suksesi, mbrojtja e konsumatorit mbetet ende çështje e hapur. Kështu, një numër sfidash mbeten për tu adresuar në të ardhshmen, siç është përcaktimi i konceptin evoluues të prodhuesve dhe mbrojtjen e konsumatorëve nga praktikatat e reja të ekonomisë bashkëpunuese si dhe përshtatja e politikës me zhvillimet teknologjike.

3.1. Opsioni asnjë ndryshim

Lënia e gjendjes aktuale të pandryshuar në relacion me Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorit, do të thotë që shumë konsumator do të vazhdojnë të përballen me vështirësi për të siguruar te drejtat e plota dhe parimet themelore në rastet kur ata ballafaqohen me shitësit e produkteve dhe ofruesit e shërbimeve.

3.2. Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore

Opsioni për 'përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit' është një opsion që e parashikon procedura e hartimit në çdo Koncept Dokument në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Ky opsion shikon në përmirësimin e mënyrave për arritjen e objektivave përmes zbatimit të duhur të detyrimeve ekzistuese ligjore. Në këtë kuadër, ekziston mundësia të arrihen objektivat e koncept dokumentit duke e përmirësuar zbatimin e duhur të detyrave ekzistuese ligjore përmes ndarjes së buxhetit shtesë në rast se dispozitat aktuale buxhetore nuk janë të përshtatshme për arritjen e objektivave. Në këtë mënyrë mundësohet që me buxhet të shtuar të synohen dy objektiva bazë siç janë; rritja e numrit të stafit, trajnimeve, inspektimeve, si dhe aktiviteteve shtese për sensibilizimin e operatoreve dhe konsumatorëve për t'iu përmbajtur dhe respektuar dispozitave ligjore në fuqi. Por në anën tjetër, ky opsion do të adresonte deri në një masë të caktuar efektet dhe shkaqet të cilat shpjen tek problemi kryesor që po analizohet në këtë Koncept Dokument. Ky opsion aktualisht nuk ka mundësi të konsiderohet sepse Ligji për Mbrojtjen e Konsumatorit paraqet fushë e cila kërkon ndryshim akute për zbatimin sa më të drejtë të tij.

Kapitulli 3.3. Opsioni i tretë

Miratimi i konceptit të plotësim ndryshimit të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit është në përputhje me politikat qeveritare karshi përmirësimit të përhershëm të kualitetit të jetës të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Këto politika parashihen në përputhje të plotë me kërkesat, nevojat dhe interesat vitale të konsumatorëve tanë, njëkohësisht në pajtim me rrethanat, specifikat dhe mundësitë tona institucionale dhe gjithë shoqërore. Implementimi i politikave të reja përmes plotësimit të Ligjit, parasheh harmonizimin me standardet më të avancuara dhe bashkëkohore Evropiane e ndërkombëtare, gjithnjë duke e pasur pikë kryesore orientuese me synim dhe qëllim, mbrojtjen e interesave ekonomike dhe juridike, por edhe të drejtave dhe të dinjitetit të konsumatorëve.

Ky opsion është edhe rekomandimi nga grupi punues i Koncept Dokumentit. Përmes këtij opsioni synohet të arrihet plotësimi i politikave ekzistuese, më konkretisht përmes plotësimit të Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit, i cili do të duhet të merrte për bazë rekomandimet e më poshtme të dala nga analiza e këtij Koncept Dokumenti:

Rekomandimi 1: Të sigurohet që trupat zbatuese (inspektoratet) të kenë qasje në mekanizmat ligjor me cilësi të lartë, transparente, efektive dhe të drejtë.

Rekomandimi 2: Arritja e një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, për të kontribuar në funksionimin e duhur të tregut të brendshëm duke siguruar që konsumatorët mund, mbi një bazë vullnetare, të paraqesin ankesa kundër tregtarëve subjekteve që ua shkelin te drejtat, për një zgjedhje të paanshme, transparente, efektive, të shpejtë dhe të drejtë.

Rekomandimi 3: Të sigurojë që inspektorët e ngarkuar me zgjedhjen e ankesave të kenë ekspertizën e nevojshme dhe të jenë të pavarur dhe të paanshëm në vendimet e tyre.

Rekomandimi 4: Të sigurohet qasja për konsumatorët në procedurat e ankimimit dhe të sigurohet që mosmarrëveshjet e mbuluara nga Direktiva 2019/2161 (BE) për zbatimin dhe modernizimin më të mirë të rregullave të Bashkimit për mbrojtjen e konsumatorit.

Rekomandimi 5: Të filloj rregullimi i tregtisë elektronike përmes rregullave të reja që mbrojnë konsumatorin për kontratat digjitale, të cilat aktualisht janë duke u diskutuar nga Parlamenti dhe Këshilli Evropian. Me këtë rast,

- duhet të theksohen gjithashtu zhvillimet e rëndësishme që kanë ndodhur në vitet e fundit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë, të cilat duhet të përfshihen në modernizimin e kornizës ligjore të Kosovës që rregullon tregtinë elektronike.
- Në kontekstin e zhvillimeve të reja në rregullimin e tregtisë elektronike në BE, dhe duke marrë parasysh zotimet dhe angazhimet e Kosovës në MSA për te harmonizuar legjislacionin e saj me Acquis të BE, e bën qartë evidente së zhvillimet legjislative në Kosove janë absolutisht të nevojshme. Për këtë, duhet të ketë instrument ligjor që mbulon fusha të ndryshme që i përkasin një rregullimi efikas të tregtisë elektronike për rritjen e mirëqenies së konsumatorit, pa kompromentuar zhvillimin e tregtisë elektronike në vend.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Vijimisht paraqiten vlerësimet mbi të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve e të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuar në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Vlerësimet gjithashtu tregojnë rëndësinë e ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

Figure 4: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identifikuara
Ndikimet ekonomike	Mbrojtjen e konsumatorit dhe konkurrencën.
Ndikimet shoqërore	Në informimin e publikut, krim dhe siguri.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime relevante.
Ndikimet në të drejtat themelore	Në të drejtën për administrim të mirë.
Ndikimi gjinor	Nuk ka ndikime relevante.
Ndikimet e barazisë sociale	Drejt një tregu të drejt dhe barabartë.
Ndikimet tek të rinjtë	Nuk ka ndikime relevante.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Mund të ketë ndikime relevante.
Ndikimi i NVM-ve	Nuk ka ndikime relevante.

4.1. Ndikimet ekonomike

Pyetjet kryesore që janë trajtuar nga grupi punues për të identifikuar këto ndikime janë:

1. A do të zvogëlohen apo rriten shpenzimet buxhetore?
2. A do të sigurohet një mbrojtje më e mirë konsumatorëve lidhur me të drejtat e tyre?
3. A do zhvillohet një konkurrencë më e drejtë në tregun Kosovar?

1. Shpenzimi përmes procedurës administrative konsiderohen si më e ultë se sa zgjedhja e kontestit përmes Gjykatave kompetente. Mbrojtja e Konsumatorit përmes procedurës administrative do të duhet të shërbejë si në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duke përdorur metoda për të zgjidhur mosmarrëveshjen pa iu drejtuar veprimeve ligjore, ku përfitimet e një shërbimi të tillë mes tjerash mund të jenë gjithashtu të natyrës ekonomike.

2. Masat e harmonizuara të zbatimit – Rregullat aktuale kombëtare për dispozitat ndëshkuese ndryshojnë ndjeshëm në të gjithë Bashkimin Evropian. Në veçanti, jo të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së sigurojnë që gjobat efektive, proporcionale dhe dekurajuese mund të vendosen gjerësisht mbi tregtarët përgjegjës për shkelje ose gjerësisht shkelje të një dimension të Unionit Evropian.

Direktiva 2019/2161 siguron një qasje të harmonizuar ndaj dispozitave ndëshkuese, si diçka shumë relative me Ligjin e Kosovës për Mbrojtjen e Konsumatorit, pasi që konsiderohet se ka defekte teknike në dispozitat aktuale ndëshkuese në këtë Ligj. Transpozimi i kësaj Direktive mund të ndihmojë në adresimin e kësaj çështje.

3. Plotësimi i Ligjit konsiderohet se do të ndikoj ndjeshëm në ngritjen e cilësisë dhe mbrojtjen e konsumatorit, kjo ngase do të rritet dhe profesionalizohet mbikëqyrja e tregut. Përveç kësaj, reforma ka për qëllim gjithashtu për të përmirësuar mbrojtjen e konsumatorit duke i dhënë qartësi më të madhe kësaj fushe në lidhje me ku mund të drejtohen për ndihmë dhe këshilla përpos atyre ekzistuese. Përndryshe, konsumatorët me vetëbesim janë jetike për ndërtimin e një ekonomie më të fortë. Në këtë kontest, niveli i lartë i besimit të konsumatorëve i inkurajon ata (konsumatorët) të eksperimentojnë dhe të blejnë neper dyqane, duke mbështet kështu biznese të reja, rrit konkurrencën dhe krijon zhvillim ekonomik. Prandaj është e nevojshme që konsumatorët të kenë më shumë besim dhe/apo vetëbesim kur ata kanë të bëjnë me shërbim jo adekuat ose të dobët mallrash apo shërbimesh. Në këtë kontekst, vlerësohet se konkurrenca do të zhvillohet gjithashtu në mënyrë më të drejtë.

4.2 Ndikimet shoqërore

Ndikimet shoqërore të identifikuar gjatë analizës janë:

Zvogëlimi i stresit – Nëse ndodh një proces gjyqësor, zakonisht nevojitet koha (i.e. pushim nga puna) për të marrë pjesë në gjykatë, çka rezulton akumulim aktivitetesh (i.e. ngritje në volumin punëve). Kjo mund të krijojë pastaj vete vetiu stres apo shqetësim të klientëve, fakti se nuk e dinë si do t'ia dalin. Çka me shumë, vet procedura apo çështjet gjyqësore të çdo lloji janë një përvojë stresuese.

Vjen në shprehje dy-anshmëria (konsumator – tregtar) e problemit – Gjykata përfaqëson një institucion shumë më të 'ngurtë' që gjithëherë tenton të zgjidhë mosmarrëveshjet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sikundër, procedura përmes inspektorateve shtetërore është më fleksibël dhe si proces më e përgjegjshme ndaj nevojave individuale të atyre që janë të përfshirë. Prandaj, rezultati ka më shumë të ngjarë të pasqyrojë mosmarrëveshjen.

Ruajtja/mos-prishja e relacioneve konsumator – tregtar – Përgjatë zhvillimit të procedurës së trajtimit të ankesave, ndërsa nevojat e të dy palëve merren parasysh, rezultati ka më shumë të ngjarë të përshatet me nevojat e secilës palë të përfshirë. Kjo në një formë apo tjetrën mund të ndihmojë në ruajtjen e marrëdhënieve ekzistuese të klientit, të cilat (marrëdhënie) mund të jenë të dobishme nëse marrëdhënia tregtare pritet të vazhdojë. Për shembull, sikurse në rastet kur është planifikuar punë shtesë para se të ketë lindur mosmarrëveshja.

Kursimi i kohës – Në përgjithësi, seancat gjyqësore marrin shumë kohë për t'u zgjedhur, duke çuar në pritje të gjata për zgjidhjen e secilës çështjeje. Në të kundërt, një procedurë administrative eficientë mund të zhvillohet shumë më shpejt, duke rritur gjasat për një zgjidhje të shpejtë.

Krimi dhe siguria – Sa i përket krimit dhe sigurisë, plotësimi ndryshim do të duhet të ketë ndikim evident pozitiv në dukuritë e lartpërmendura dhe në rritjen e mbrojtjes së konsumatorit, meqë do të rritet mbikëqyrja. Kjo do të duhet të ndikojë në parandalimin dhe luftimin efikas të këtyre dukurive, pasi që do të shtohen llojet e sanksioneve dhe ato aktuale janë më të shpejta dhe efikase. Organi mbikëqyrës do të jetë më i profilizuar për fushën e mbrojtjes së konsumatorit, që ngrit kapacitetet e zbatimit të Ligjit dhe si rrjedhojë siguron cilësinë dhe tregtinë e drejtë.

Ndikimi në të drejtat themelore

E drejta themelore që është relevante në këtë fushë, është e drejta për administrim të mirë. Pyetjet që janë vlerësuar nga grupi punues për matjen e ndikimit në këtë të drejtë kanë të bëjnë me të drejtat themelore të konsumatorit, respektivisht:

- E drejta për prodhime të sigurta
- E drejta e konsumatorëve për informim, arsimim/edukim dhe vetëdijesim
- E drejta e konsumatorëve kundruall interesave ekonomike
- E drejta e konsumatorëve për kompensim dhe qasja praktike
- E drejta e konsumatorëve për t'u dëgjuar dhe bashkuar
- Të drejtat tjera

Direktiva për zbatimin dhe modernizimin më të mirë të mbrojtjes së konsumatorit

Direktiva e BE-s (BE / 2019/2161) u miratua nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli në 27 nëntor 2019. Në praktikë, 'Marrëveshja e Re për Konsumatorët' synon:

- Modernizimin e rregullave ekzistuese dhe plotësimin e boshllëqeve në legjislacionin aktual të konsumatorit;
- Mundësi më të mira dëmshpërblimi për konsumatorët, zbatim efektiv dhe bashkëpunim më të madh mes autoriteteve publike në një treg të përbashkët të drejtë dhe të sigurt;
- Rritjen e bashkëpunimit me vendet partnere jashtë BE-së;
- Trajtim të barabartë të konsumatorëve në tregun e vetëm dhe garanci që autoritetet kombëtare kompetente janë të autorizuar të trajtojnë çdo problem me 'cilësinë e dyfishtë' të produkteve të konsumit;
- Përmirësimin e komunikimit dhe ndërtimin e kapaciteteve për t'i bërë konsumatorët më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe për të ndihmuar tregtarët, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që të veprojnë më lehtë me detyrimet e tyre;
- Parashikimin e sfidave të ardhshme për politikën e konsumatorit në një mjedis ekonomik dhe teknologjik që zhvillohet shpejt.

Transparenca e tregut (apo tregjeve) në internet

Sot, kur konsumatorët blejnë në tregun e elektronik (internet), ata nuk e dinë gjithmonë se nga kush blejnë produktin ose shërbimin (i.e. një tregtar profesionist ose një konsumator tjetër). Mosnjohja e identitetit të furnizuesit paraqet një problem sepse nëse diçka nuk shkon si duhet, rregullat e mbrojtjes së konsumatorit nuk zbatohen kur blihet nga një individ tjetër privat. Rregullat e reja e bëjnë më të lehtë për konsumatorët të vlerësojnë rreziqet kur bëjnë pazare në treg (apo tregje) në internet. Në këtë mënyrë, parashihet që tani e tutje konsumatorët do të informohen nëse personi që shet mallra ose shërbime në internet është një tregtar ose një individ tjetër privat, dhe paralajmëron që rregullat e BE-së për mbrojtjen e konsumatorit nuk zbatohen kur furnizuesi nuk është tregtar. Tregu në internet parashihet që gjithashtu të tregojë nëse furnizuesi ose vetë tregu është përgjegjës p.sh. për dorëzimin ose për trajtimin e kthimeve nën të drejtën e tërheqjes.

Fuqizimi i mëtutjeshëm i konsumatorit

Konsumatorët gjithashtu do të dinë se ku të drejtohen në rast të problemeve. Direktiva gjithashtu ofron një kornizë të përmirësuar në:

- Të drejtat e konsumatorit për shërbime dixhitale “falas”;
- Statusin e ofertave;
- Transparencën ndaj pasqyrës së konsumatorëve;
- Çmimet personale (sipas rastit);
- Rishitjes së biletave të eventeve të blera në kabina;
- Sigurimi që pretendimet për uljen e çmimit të jave origjinale (të vërteta).

Fuqizimi i mbrojtjes së konsumatorit

Direktiva gjithashtu propozon masa për t'u përmirësuar:

- Kompensimi për viktimat e praktikave të padrejta tregtare;
- Trajtimi i cilësisë së dyfishtë të mallrave të konsumit;
- Mbrojtje më e mirë kundër praktikave të padrejta në rastin e shitjeve ‘derë-më-derë’ (shitësve mobil pran shtëpive) dhe ekskursioneve komerciale.

Kapitulli 5: Sfidat në mbledhjen e të dhënave

Grupi Punues për hartimin e koncept dokumenti në strukturën e tij përbërëse është përfaqësuar gjithashtu me zyrtarë të fushës së mbrojtjes së konsumatorit të cilët kanë mundur qasjen dhe sigurimin e informacionit teknik të nevojshme për të punuar të gjithë anëtarët e grupit punues në koncept dokument. Grupi punues është udhëhequr nga zyrtar te Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit, duke mundur kështu sigurimin e informacionit primar teknik të nevojshëm për të hartuar koncept dokumentin. Këto informata i kanë ndihmuar të gjithë anëtarët e grupit punues të identifikojnë më mirë shkaqet dhe efektet në përcaktimin te problemit kryesor. Gjithashtu, përbërje të grupit punues përfaqësohet nga Ministrit linje (konkretisht atë te Financave), Zyrës së Kryeministrit dhe Qeveris, pastaj Departamenteve rreth teknikalliteteve administrative në MTI, sikurse ai Ligjor, Financave, Barazi Gjinore, për Komunikime me Publikun dhe Integritet Evropiane, si dhe dikastereve linje sikurse Inspektoratit të Tregut, Departamenti i Tregtisë dhe ai i Industrisë, duke mundur kështu një kompozicion të përshtatshëm dhe të gjerë të grupit punues për të siguruar informata esenciale për të hartuar këtë dokument sipas udhëzuesit dhe doracakut për hartimin e koncept dokumenteve. Gjithashtu, koncept dokumenti i është nënshtruar të gjitha procedurave të parapara me udhëzues për konsultim dhe diskutim publik duke mundur mbledhjen e informacioneve të nevojshme edhe nga palët e interesit, shoqëria civile, dhe niveli lokal i qeverisjes. Gjatë, hartimit të koncept dokumentit nuk ka pasur raste të cilat kanë paraqitur sfida në mbledhjen e informacionit apo raste të cilat kanë cenuar ecurinë e punës si pasojë e mungesës së informacionit esencial.

Kapitulli 6: Komunikimi dhe konsultimi

Departamenti për Mbrojtjen konsumatorit, përkrahur nga Projekti ‘Tregti e Lirë e Mallrave’ financuar nga Komisionit Evropian në kuadër të MINT, ka konsultuar faktorë relevantë vendorë e ndërkombëtarë, si pjesë e procesit të identifikimit dhe formulimit të politikave mbi Mbrojtjen e Konsumatorit. Palët kryesore të konsultuara përfshijnë Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Inspektoratet kompetente Qeveritare (Tregut dhe Infrastrukturës së Cilësisë), Banka Qendrore, Rregullatorët kryesor të ndërmarrjeve publike, si dhe ministritë dhe agjencitë e Qeverisë së Kosovës. Janë mbajtur edhe konsultime me një numër ekspertësh vendorë e ndërkombëtarë. Konsultime të mëtutjeshme do të bëhen në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës, pasi të ketë filluar procesi formal i hartimit të Ligjit.

Figura 7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit ka synuar përfshirjen e palëve të interesuara në përkufizimin e problemit, vlerësimin e ndikimeve dhe ofrimin e opsioneve për adresimin e problemit. Komunikimi me publikun e gjerë do të bëhet në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes dëgjimeve publike dhe shpërndarjes së dokumenteve publike për informim publik.					
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/nj oftimi	Afati Kohor	Personi përgjegjës
Konsultim me Këshillin për Mbrojtjen e Konsumatorit	Aktorët kryesor (OJQ/Shoqata dhe publik) për mbrojtjen e konsumatorit	Takim i targetuar	Përmes takimit të rregullt; Përmes e-mail dhe telefonit	Tetor, 2020	Kryesues i Grupit Punues
Konsultimi me institucionet publike dhe OJQ/Shoqata për Konsumator	Institucionet publike dhe OJQ/Shoqata për Konsumator	Konsultimi paraprak	Përmes e-mail	Nëntor, 2020	Grupi Punues në bashkëpunim me Divizionin e Komunikimit në MTI
Konsultimi publik me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik	Përmes e-mail dhe platformës	Dhjetor	Grupi Punues në bashkëpunim me Divizionin e Komunikimit në MTI

Aktivitetet e komunikimit që do të pasojnë pas miratimit të koncept dokumentit do të jenë:

- a) **Fletëpalosjes digjitale**, e cila do të përmbajë të dhëna informuese dhe risive karshi plotësimit ndryshimit të Ligjit. Fletëpalosja do të prezantohet në platformat elektronike të MTI-se dhe në media;
- b) **Video-spoti**, që do të përmbajë të dhëna informuese dhe risive për fushën e metaleve të çmuara për grupet e interesit dhe për publikun. Video-spoti do të prezantohet në platforma elektronike dhe rrjetet sociale të MTI-së dhe në media.

Departamenti për Mbrojtjen konsumatorit, përkrahur nga Projekti ‘Tregti e Lirë e Mallrave’ financuar nga Komisionit Evropian në kuadër të MTI-s, ka konsultuar faktorë relevantë vendorë e ndërkombëtarë, si pjesë e procesit të identifikimit dhe formulimit të politikave mbi Mbrojtjen e Konsumatorit. Palët kryesore të konsultuara përfshijnë Këshilli për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Inspektoratet kompetente Qeveritare (Tregut dhe Infrastrukturës së Cilësisë), Banka Qendrore, Rregullatorët kryesor të ndërmarrjeve publike, si dhe ministritë dhe agjencitë e Qeverisë së Kosovës. Janë mbajtur edhe konsultime me një numër ekspertësh vendorë e ndërkombëtarë. Konsultime të mëtutjeshme do të bëhen në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Kosovës, pasi të ketë filluar procesi formal i hartimit të Ligjit.

Kapitulli 7: Krahasimi i opsioneve

Siç është cekur më lartë, grupi punues ka trajtuar gjithsej tri opsione për adresimin e problemit: Opsioni 1 (*status-quo*), Opsioni 2 (ndryshimi i mënyrës së zbatimit dhe ekzekutimit) dhe Opsioni 3 (hartimi i Ligjit të ri).

Opsioni 2 synon adresimin e problemit kryesor përmes ndërmarrjes së aktiviteteve të caktuara që ndryshojnë mënyrën e deritashme të zbatimit dhe ekzekutimit të politikave dhe ligjeve në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit. Ky opsion me këtë rast nuk mund të zbatohet sepse tek Ligji aktual për konsumator janë evidentuar boshllëqe si në fushën e zbatimit, njashtu karshi politikave të BE-së të cilat konsiderohet se duhet implementuar.

Opsioni 3 është opsioni që parasheh ndryshime të politikave dhe ligjore, gjegjësisht plotësim ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara për zbatimin e tij.

7.1. Planet e zbatimit për opsionin 3

Plani i Zbatimit të Opsionit 3									
Qëllimi i Politikës	Përmirësimi i kornizës ligjore në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit							Shifra e kostos së përlogaritur (€)	
Objektivi Strategjik	Zhvillimi i mëtejshëm i mbrojtjes së konsumatorit								
Objektivi specifik 1: Përafrimi i legjislativitetit të Kosovës me atë të BE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.	Produkti 2.1:	Përmirësimi i gjendjes aktuale në relacion me mbrojtjen e së drejtës së konsumatorit							
		Aktivitetet	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Inst./Dep. përgjegjës	
		Përmirësimi i gjendjes aktuale në relacion me mbrojtjen e së drejtës së konsumatorit (angazhimi i stafit aktual)	26940500	269451500	269501500	269551500	269601500	DMK/MINT	141250.00
Objektivi specifik 3: Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e konsumatorit	Produkti 3.2	Mbajtja sesioneve informuese me sektorin privat lidhur me kornizën ligjore në fuqi, përgatitja e broshurave							
		Mbajtja sesioneve informuese me sektori privat lidhur me kornizën ligjore në fuqi, përgatitja dhe shpërndarja e broshurave	4000	5000	6000	6000	6000	DMK/MINT	27000.00

7.2. Krahasoni mes tre opsioneve

Në këtë Koncept Dokument, siç është cekur më lartë, janë trajtuar gjithsej tri opsione: 1) opsioni asnjë ndryshim; 2) opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit dhe 3) opsioni për plotësim ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Grupi punues ka përdorur analizën e kosto-efektivitetit për krahasimin e opsioneve. Pra, kriteri krahasues me kosto shtesë, brenda buxhetit të caktuar, në raport me efektin më të madh për arritjen e objektivave të Koncept Dokumentit. Objektivat, siç janë cekur në Kapitullin 2, janë:

- Funksionimi i lirë i tregut,
- Mbrojtja e konsumatorit dhe mundësimin e konkurrencës së drejtë,
- Përputhshmëri më e lartë me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian,
- Zhvillimi i mëtejshëm i mbrojtjes së konsumatorit;

Edhe kostot e opsioneve 1 dhe 2 është brenda buxhetit të caktuar. Mirëpo me këtë opsion objektivat e Koncept Dokumentit do të jenë të pa arritshme, ngase do të vazhdojnë problemet e njëjta lidhur me mundësin e limituar të mbrojtjes së konsumatorit, dëmtimin e konsumatorëve dhe konkurrencës.

Vlerësimi i koston dhe efektit në arritjen e objektivave është bërë me shenjat (+) që nënkupton ndikimin pozitiv, dhe (-) ndikimin negativ. Në rastet kur janë përdorur më shumë se një shenjë, tregohet se ndikimi do të jetë i nivelit më të lartë dhe objektivat do të arrihen më shpejtë. Përfundimi i grupit punues, bazuar në analizën e kosto-efektivitetit, është se opsioni 3 është më i favorshëm se sa dy opsionet tjera.

Tabela 5: Krahasoni i opsioneve

Metoda e krahasimit: Analiza e Kosto-Efektivitetit		
	Opsioni 1 dhe 2: Asnjë ndryshim	Opsioni 3: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit
Zhvillimi i mëtejshëm i mbrojtjes së konsumatorit	- -	+
Përafrimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorit	-	+
Ngritja e kapaciteteve në fushën e mbrojtjes së konsumatorit	-	+
Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e konsumatorit	-	+
Kostot relevante	168,250.00 euro	292,774.00 euro
Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti	Viti
	0	
Përfundimi	Nuk rekomandohet	Opsioni i rekomanduar

Opsioni 2 synon adresimin e problemit kryesor përmes ndërmarrjes së aktiviteteve të caktuara që ndryshojnë mënyrën e deritashme të zbatimit dhe ekzekutimit të politikave dhe ligjeve në

fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit. Ky opsion me këtë rast nuk mund të zbatohet sepse tek Ligji aktual për konsumator janë evidentuar boshllëqe si në fushën e zbatimit, njashtu karshi politikave të BE-së të cilat konsiderohet se duhet implementuar.

Opsioni i rekomanduar nga grupi punues është Opsioni 3, për hartimin e Ligjit të ri për Zgjedhjen Alternative të Kontesteve për Konsumator, që synon adresimin e problemit të identifikuar dhe analizuar në këtë Koncept Dokument.

Figura 6: Plani i zbatimit të opsionit të preferuar

Plani i Zbatimit të Opsionit 3									
Qëllimi i Politikës	Përmirësimi i kornizës ligjore në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit								Kosto e përlllogarit (€)
Objektivi Strategjik	Zhvillimi i mëtjshëm i fushës së mbrojtjes së konsumatorit								
Objektivi specifik 1: Përafrimi i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorit.	Prod. 1.1:	Plotësim ndryshimi i Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit i miratuar dhe në zbatim							
		Aktivitetet	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Inst./De p. përgjegjës	
		Hartimi dhe miratimi i plotësim ndryshimit të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit (Angazhimi i Stafit aktual)	26940 500	26945 1500	26950 1800	26955 1800	26960 /	DMK, Dep.Ligj./ MINT	140350.00
		Hartimi i akteve nënligjore që derivojnë nga Ligji për Zgjedhjen Alternative të Kontesteve për Konsumator	500	1500	1800	/	/	DMK, Dep.Ligj/ MINT	3800.00
Objektivi specifik 3: Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e konsumatorit	Prod. 3.1:	Mbajtja e sesioneve informuese me sektorin privat lidhur me kornizën ligjore në fuqi, përgatitja e broshurave							
		Mbajtja e sesioneve informuese me sektorin privat lidhur me kornizën ligjore në fuqi	500	1500	1800	1800	1800	DMK/ MINT	7400.00
		Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve vetedisuese	4000	5000	6000	6000	6000	DMK/ MINT	27000.00

		Kërkesa shitesë për staf te ri (4 zyrtarë- dy me koef.9, nje me koef. 8, dhe nje me koef.7	/	27748	27886	28025	28165	DMK/ MINT	111824.00
		Furnizimi me paisje dhe inventarë te nevojshem per pune per stafin e rekrutuar		2400	/	/	/	DMK/ MINT	2400.00

8.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Sipas të gjitha analizave të bëra nga ky Koncept Dokument, siç është cekur edhe më lartë, i vetmi opsion që garanton për adresimin e problemeve të identifikuar në fushën e Mbrojtjen e Konsumator është adresimi me ndryshime ligjore, meqë shkakut kryesor i problemeve të identifikuar janë dispozitat ligjore që krijojnë efekte në këtë sistem.

Plani për zbatimin e këtij Koncept Dokumenti, me kusht që aprohet me opsionin e rekomanduar, është si në vijim:

Veprimi	Afati kohor
1. Miratimi i Koncept Dokumentit për Mbrojtjen e Konsumatorit	K4 2021
2. Hartimi i Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit.	K2 2022
3. Aprovimi Ligjit për Konsumator në Qeverinë e Republikës së Kosovës.	K4 2022
4. Aprovimi i Ligjit 06/L-34 për Konsumator në Kuvendin e Republikës së Kosovës	K4 2022
5. Hyrja në fuqi i Ligjit 06/L-34 për Konsumator	K4 2022
6. Zbatimi i Plotësim Ndryshimit të Ligjit për Konsumator	K4 2022 -

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm nga kostoja e ndikimit
		Po	Jo		I lartë/i ulët

Koncept dokumenti për Mbrojtjen e Konsumatorit

Vendet e punës ¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x		
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x		
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		x		
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x		
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		x		
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		x		
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		x		
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		x		
	A do të krijohen biznese të reja?		x		
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënjes së informatave të reja?	X		L	U
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënjes së informatave për bizneset?		x		
Tregtia	A pritët të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		x		
	A pritët të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		x		
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		x		
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		x		
Investimet	A pritët që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		x		
	A pritët që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		x		
	A do të rriten investimet nga diaspora?		x		
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		x		
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		x		
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		X		
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		X		
	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		x		
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimin?		X		
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		X		
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?	X		L	L
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?	X		U	U

¹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

Koncept dokumenti për Mbrojtjen e Konsumatorit

	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x		
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x		
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x		
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?	x		L	U
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		x		
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		x		
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		x		

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm dhe kostoja e ndikimit
		Po	Jo		
Vendet e punës ²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x		
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x		
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		x		
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		x		
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x		
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		x		
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		x		
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		x		
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		x		
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		x		
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		x		
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		X		
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		X		
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		X		
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		X		
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		X		
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		X		
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		X		
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		X		
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		X		
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?		X		
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		X		

² Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		X		
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		X		
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?		x		
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	X		L	U
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	X		L	U
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		x		
	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		X		
Shëndeti dhe siguria publike ³	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		X		
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?	X		L	U
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		X		
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		X		
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		X		
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		X		
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		X		
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		X		
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?	X		L	U
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?	X		L	U
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		X		
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?	X		L	L
	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		X		

³ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi pritshëm kostoja e ndikimit
		Po	Jo		
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		X		
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		X		
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		X		
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		X		
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		X		
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		X		
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		X		
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		X		
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		X		
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		X		
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		X		
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		X		
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		X		
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		X		
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara?		X		
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		X		
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		X		
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		X		
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		X		

Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		X		
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		X		
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		X		
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		X		
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		X		
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		X		
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		X		
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		X		
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		X		

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi pritshëm kostoja e ndikimit
		Po	Jo		
Dinjteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		X		
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?		X		
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?		X		
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		X		
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		X		
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?		X		
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		X		
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		X		
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?		X		
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?	X		L	U
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	X		L	U
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		X		
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		X		
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		X		

Koncept dokumenti për Mbrojtjen e Konsumatorit

Trajtimi i barabartë	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	X		L	U
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		X		
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		X		
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		X		
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		X		
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?	X		L	L
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		X		
	A ndikohet qasja në drejtësi?		X		